

QSUT (SHERBIMI I 2TE I KARDIOLOGJISE)  
MINISTRIA E SHENDETESISE, QKCSA, ISKSH.

# Udhërrëfyes për menaxhimin e Kardiomiopatise Hipertrofike

Përfshire dhe klasifikimin e kardiomiopative

Publikuar: Dhjetor 2010

Rishikimi: Sipas Nevojës

Eshtë një dokument klinik konsensual ekspertesh i përshtatur sipas dokumentit te  
Kolegjit Amerikan te Kardiologjisë/Shoqatës Evropiane te Kardiologjisë mbi  
Kardiomiopatine Hipertrofike.

Grupi i punës për hartimin e Udhërrëfyesit “Për menaxhimin e kardiomiopatise hipertrofike”, ishte i përbëre nga përfaqësues te QSUT, Shërbimi i 2te i Kardiologjisë .

Përgjegjës per përbajtjen shkencore te materialit janë:

Spiro Qirko

Gerhard Sulo

Diana Kristo

Endrin Koni.

Vladimir Gusmari, përfaqësues i Qendrës Kombëtare te Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit te Institucioneve Shëndetësore-QKCSA-ISH;

Maksim Bozo, ishte përfaqësues i Ministrisë se Shëndetësisë

Naun Sinani , përfaqësues i ISKSH-se

Përdoruesit e këtij udhërrëfyesi: Ky Udhërrëfyes është për përdorim nga kardiologë te QSUT, kardiologë te spitaleve te rretheve, specialiste kardiologë ne mbare vendin si dhe nga mjeke te kujdesit parësor.

Ky udhërrëfyes është përfunduar ne Dhjetor 2010.

Udhërrëfyesi është miratuar nga Shefi i Shërbimit, Prof. Dr. Spiro QIRKO

Data e rishikimit: Sipas nevojës

Udhërrëfyesi është përshtatur nga një dokument klinik konsensual ekspertesh te Kolegji Amerikan te Kardiologjise/Shoqatës Evropiane te Kardiologjisë mbi Kardiomiopatine Hipertrofike : European Heart Journal (2003) 24, 1965–1991ACC/ESC Expert consensus document, American College of Cardiology/European Society of Cardiology Clinical Expert Consensus Document on Hypertrophic Cardiomyopathy,A report of the American College of Cardiology Foundation Task Force on Clinical Expert Consensus Documents and the European Society of Cardiology Committee for Practice Guidelines.

Nr I faqeve 27

## Tabela e permajtjes

Pasqyra e tabelave .....	4
Pasqyra e figurave.....	4
Lista e shkurtimeve( akronimet e perdonura ).....	4
Parathenie ( rendesia e problemit ).....	4
Objektivi .....	5
Klasifikimi i kardiomiopative dhe perkufizimi kontemporan i kardiomiopative .....	5
Klasifikimi .....	7
I.Kardiomiopatite primare .....	7
<b>A.Kardiomiopatite Gjenetike .....</b>	<b>7</b>
<b>B.Kardiomiopatite Mikse ( gjenetike dhe jo gjenetike ) .....</b>	<b>9</b>
C.Kardiomiopatite e Fituara.....	10
II.Kardiomiopatite Sekondare .....	11
Kardiomiopatia Hipertrofike .....	13
Konsiderata te per gjithshme dhe perspektiva .....	13
Terminologji, percaktimë dhe diagnoza klinike.....	13
Obstruksioni i traktit zbrasë se VM .....	14
Diagnoza molekulare dhe konsiderata mbi gjenetiken .....	15
Konsiderata te per gjithshme ne lidhje me historine natyrore dhe ecurine klinike.....	18
Simptomatika dhe strategjite e menaxhimit farmakologjik .....	20
Pacientet asimptomatike .....	23
Opsione terapeutike per pacientet qe nuk i per gjigjen terapise medikamentoze.....	24
Peisimi bikameral.....	26
Ablacioni septal perkutan me alkool ( ASP ) .....	28
Stratifikimi i riskut.....	31
Parandalimi .....	34
Rekomandime per atletet.....	35
Fibrilacioni Atrial ( FA ).....	35

## **Pasqyra e tabelave**

Fq 17 - Tabela 1. Krahasimi i miptomise septale dhe ablacionit perkutan septal me alkool

Fq 20 - Tabla 2. Faktoret e riskut per vdekje te papritur ne paciente me kardiomiopati hipertrofike

## **Pasqyra e figurave**

Fq 8 - Fig. 1 Paraqitja klinike dhe strategjite e trajtimit per nengrupet e pacienteve Brenda spektrit te gjere te kardiomiopatise hipertrofike.

Fq 10 - Fig. 2 Shtigjet kryesore te progresionit te semundjes ne kardiomiopatine hipertofike.

## **Liste e shkurttimeve( akronimet e perdonura )**

ACC – kolegji amerikan i kardiologjise

ESC – Shoqata Europiane e Kardiologjise

HVM – hipertrofia e ventrikulit te majte

VM – ventrikuli i majte

KMPH – kardiomiopati Hipertrofike

EKG – Elektrokardiograma

DDD - Peisim ne dy dhoma, atrium ventrikul

FA - Fibrilacion atrial

VP - Vdekje e papritur

IK - Insuficience kardiake

HTA – Hipertension arterial

TZ – trakti zbrazes

AM – atrium i majte

SAK – Semundja e Arterieve Koronare

ASP – Ablacion septal perkutan

LAD – Arteria e Majte Zbriteze

ICD – defibrilator i implantuar

TV – Takikardi ventrikulare

AHA – Shoqata Kardiake Amerikane

BAV – Bllok atrio-ventrikular

## **Parathenie ( rendesia e problemit )**

KMPH eshte nje patologji komplekse dhe relativisht e shpeshte gjenetike ( rreth 1:500 ne popullaten adulte ) e cila ka qene subjekt i investigimeve dhe paqartesive ne 40 vitet e fundit. KMPH prek ted y gjinite dhe prek si raca aashtu edhe zona gjeografike pa dallim te rendesishem. Duket te jete e nendiagnostikuar tek grate, minoritetet, dhe shtresat e

uleta te shoqerise. KMPH eshte nje shkak I shpeshte I vdekjes se papritur tek te rinde ( perfsheire keta edhe atletet e trajnuar ). Per shkak te heterogenicitetit te shfaqjes klinike dhe ecurise, KMPH shpesht paraqet nje problem te paqarte per sa I perketo protokolleve te sakta dhe detajuara te trajtimit ; si per kardiologet, ashtu edhe per mjeket e tjere. Megjithë prezantimin e teknikave te reja kuruese qe kane ne shenjester nengrupe te caktuar pacientesh, perseri ka kundershtime dhe diskutime duke bere qe zhvillimi I njohurive mbi te te nxjerre ne pah pyetje te reja. Prandaj, autoret gjykojne se ka ardhur koha te diskutohen arritjet dhe teknikat kuruese per te bere nje vleresim adekuat te menaxhimit te KMPH.

## Objektivi

Ky dokument ka për synim te ofroje një këndvështrim te qarte mbi njohuritë aktuale per KMPH. Ai synon te informoje mjeket kardiologe dhe atët familjes mbi opinionet aktuale te ACC/ESC mbi diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e pacienteve me KMPH. Ai synon gjithashtu te japë një informacion mbi te rejat diagnostike dhe teknikat eksperimentale apo relativisht te reja te trajtimit. KMPH mbetet akoma një topikë ne studim. Prandaj, te dhënati e këtij dokumenti do te shërbejnë si një udhëheqës për menaxhimin e pacienteve pasi dihet qe me gjithë potencialin letal, KMPH mbetet një sëmundje e shtrire ne kohe. Synimi baze, është qe mjeket praktikues dhe kardiologë te jene ne dijeni me te rejat e fundit për një optimizim te ndjekjes se këtyre pacienteve.

## Klasifikimi i kardiomiopative dhe perkufizimi kontemporan i kardiomioptive

Klasifikimi eshte nje material i pershtatur dhe bazohet ne nje dokument shkencor nga keshilli I kardiologjise klinike te "American Heart Association", komiteti I "Insufficiencies Kardiak e Transplantit", Grupeve te punes inter disiplinore dhe keshilli I epidemiologjise dhe parandalimit.

Autoret kryesore jane : Barry J. Maron, Jeffrey A. Towbin, Gaetano Thiene, Charles Antzelevitch, Domenico Corrado, Donna Arnett, Arthur J. Moss, Christine E. Seidman, James B. Young. Data e Publikimit te tij eshte 2006

Rendesia e problemit

Klasifikimi I semundjeve te muskulit te zemres eshte pare te jete nje detyre e veshtire dhe nje process kompleks I cili ne mjaft aspekte mund te jete kontradiktor. Gjuha e pershtatshme e perdonur per te perkufizuar eshte nje pike kyse. Ketu propozohet nje klasifikimi ri dhe rigoroz i kardiomiopative me perkufizimet perkatese. Ky dokument perben nje reference te rendesishme per kete heterogenitet entitetesh mjekesore. Me rendesi te vecante eshte njofta qe ky dokument i ben evolucionit te shpejte te njohurive mbi problemin si dhe gjenetiken molekulare. Po keshtu, per here te pare ky klasifikim permblehd edhe patologji te rralla dhe te perkufizuara ne dekaden e fundit.

**Hyrje**

Kardiomiopatite jane nje grup heterogen semundjesh. Percaktimi dhe klasifikimet e ndryshme kane krijuar nje kaos per sa i perket implikimeve klinike dhe ato te parandalimit ne kendveshtrimin e shendetit publik. Shume klasifikime te ofruara nga literatura jane ne nje mase kontradiktore per sa i perket prezantimit. Perpjekjet e fundit formale per te shkruar nje dokument konsensual datoje 1995 te hartuar nga Shoqata Boterore e Shendetesise. Megjithate njohja dhe identifikimi i semundjeve te reja dekaden e fundit, te rejet ne fushen diagnostike dhe njohja e proceseve shkak-pasoje kane bere qe ky klasifikim te duket jo i kohes ne shume aspekte. Zhvillimet ne fushen gjenetike molekulare si dhe identifikimi i defekteve te kanaleve jonike qe shkaktohen nga mutacionet gjenetike kane cuar ne nevojen e riformatimit te mjaft terminologjive dhe percaktimeve.

Ky panel autoresh, kane hartuar kete dokument konsensual per klasifikimin e Kardiomiopative i cili bazohet ne zhvillimet e reja per sa i perket percaktimit te semundjeve qe prekin miokardin.

### **Konsiderata te pergjithshme**

Koncepti mbi semundjen e muskulit te zemres ka evoluar. Keshtu ne 1850, miokarditi ishte i vetmi npcion i patologjise se muskulit te zemres. Ne 1900 u fut koncepti i semundjes primare te muskulit te zemres. Ne 1957 eshte perdonur per here te pare termi "kardiomiopati". Ne 1980, kardiomiopatite klasifikoheshin si "semundje te muskulit te zemres me shkak te panjohur", duke reflektuar keshtu nje mungese informacioni mbi shkaktaret dhe mekanizmat baze qe i shkaktojne.

Ne 1968, WHO i ripercaktoi kardiomiopatite si "semundje me etiologji te ndryshme dhe te panjohur ne te cilat tipari kryesor eshte kardiomegalia, dhe insuficiencia kardiake ». klasifikimi i fundit i 1995 i percakton kardiomiopatite si « semundje te miokardit te shoqeruara me disfunkcion kardiak »- duke perfshire edhe displazine aritmogenike te ventrikulit te djathte dhe kardiomiopatine restrikitive primare.

### **Percaktimi dhe klasifikimi aktual i propozuar (2006)**

Ky panel ekspertesh propozon qe kardiomiopatite te quhen " Nje grup heterogen semundjesh te miokardit te shoqeruara me disfunkcion mekanik dhe/ose elektrik qe zakonisht ( por jo domosdoshmerisht shfaqet me hipertrofi te papershtatshme ventrikulare ose dilatacion dhe qe shkaktohen nga nje mori shkaqesh kryesisht gjenetike. KMP jane ose te lokalizuara vetem ne zemer ose jane pjesa e crregullimeve sistemike qe shpesh cojne ne vdekje kardiake apo invaliditet si pasoje e insuficiencies kardiake."

Brenda ketij spektri te gjere percaktimesh, kardiomiopatite shoqeroohen me Insuficience Kardiake dhe demtim te performances se ventrikulit te majte i cili mund te jetë mekanik apo elektrik primar.

Keshtu, sindroma e QT se zgjatur dhe ai i Brugades jane semundje primare elektrike pa anomali histopatologjike qe te jene substrat perqejges per zhvillimin e aritmive. Futja e

kardiomiopative qe kane ne baze difekte te kanaleve jonike eshte gjykuar nje avantazh i ketij klasifikimi krahasuar me ate te meparshmin.

Duhet patur parasysh se gjendje te tilla si tumoret primare ose metastatike intrakavitare ose intramiokardiale, semundjet qe prekin endokardin – me ose pa prekje te miokardit si dhe kardiomiopatia hipertrofike hypertensive nuk jane futur ne klasifikimin e ketij paneli.

## Klasifikimi

Kardiomiopatite (KMP) ndahen ne dy kategori te medha te bazuara ne organin predominant te prekur.

KMP primare qe jane vetem ato qe kufizohen ne prekjen e muskulit kardiak dhe jane te pakta ne numer.

KMP sekondare jane ato qe kane prekje te miokardit ne kuadrin e nje prekje multi organore. Keto forma jane njojur me pare si “KMP specifike”.

Ne baze te ketyre konsideratave klasifikimi duhet te perfshije ato primare (gjenetike mikse dhe te fituara) dhe sekondare.

### I.Kardiomiopatite primare

#### A.Kardiomiopatite Gjenetike

##### **Kardiomiopatia Artitmogenike e Ventrikulit te Djathte.**

Eshte nje forme jo e zakonte e trashegueshme e semundjes se miokardit ( rreth 1:5000 ) e perkuqzuar relativisht vone ( rreth 20vjet me pare ). Prek kryesisht VD me humbje progresive te miociteve dhe zevendesim me qeziza yndyrore apo fibroadipoze. Shpesh shoqerohet me miokardit.

Nuk konsiderohet nje KMP inflamatore primare. Ne 75% te pacienteve shihet evidence e prekjes se VM, miokarditi, dhe zevendesim fibroadipoz i qelizave miokardiale.

Shfaqjet klinike shpesh konsistojne ne takiaritmi ventrikulare si dhe vdekja e papritur **sidomos ne moshat e reja.**

Nuk ekziston nje test specifik diagnostik por kerkohet nje **vleresim i gjere dhe kombinim informacioni per te vendosur diagnozen.** Shpesh jane shenjat si sinkopi, aritmite apo arresti kardiak si dhe zgjerimi i dhomave te zemres qe ngrejne dyshimin per kete patologji. Testet diagnostike perfshijnë: EKG-ne, ekokardiogramen, angiografine e VD, rezonancen magnetike dhe skanerin. Biopsia endomiokardiale nga muri i lire i VD eshte nje marker sensitiv. EKG-ja zakonisht tregon repolarizim anormal me T negative ne

lidhjet V1-V3 me vale epsilon. Ne shumicen e rasteve kjo patologji ka percjellje autozomale dominante me penetrance jot e plote.

### **Semundja e sistemit te percimit**

Semundja Lenegre, karakterizohet nga defektet progresive te sistemit percues ne sistemin His-Purkinje qe cojne ne zgjerim te kompleksit QRS,pauza te gjata, dhe bradikardi qe mund te jape sinkop. Semundja e sinusit te semure eshte fenotipikisht e ngjashme me kete patologji. Shfaqja familjare e kesaj patologje eshte raportuar me patern autozomal dominant trashegimie.

### **Patologjite e kanaleve jonike**

Ne baze te ketyre patologjive qendron mutacioni i gjeneve qe kodon proteinat e kanaleve jonike te Na – K. Ketu futen sindroma me zgjatje te QT, Sindroma Brugada. Nje perqindje e vogel ( 5 – 10% ) e vdekjes se papritur tek femijet, lidhet me defektet e kanaleve jonike.

### **Sindroma e QT se zgjatur**

Perben sindromen me te shpeshte te patologjise se kanaleve te joneve karakterizohet nga zgjatja e repolarizimit ventrikular dhe intervalit QT, “Torsades se majes”, dhe riskut per sinkop dhe vdekje te papritur. Shprehja fenotipike ne EKG shkon nga 25- 50% te pjestareve te familjeve te prekura.

Dy paterne trashegimie jane pershkruar ne lidhje me kete sindrome : nje forme e rralle autozomale recessive e shoqeruar me shurdhim (sindroma Jervell dhe Lange-Nielsen) dhe sindroma tjeter me e shprehur me percim autozomal dominant (sindroma Romano-Ward).

### **Sindroma Brugada**

Kjo sindrome eshte relativisht nje entitet i ri klinik qe shoqerohet me vdekje te papritur kryesiht tek moshat e reja. E pershkruar per here ne 1992, ajo dallohet nga paterni elektrokardiografik i cili konsiston ne bllok te deges se djathte dhe ngritje e luget e ST ne lidhjet anteriore.(V1-V3). Shpesh, ky patern eshte i fshehur dhe mund te zbulohet me administrimin e flekainidit, ajmalines dhe prokainamidit. Sindroma e vdekjes se papritur naten e verejtur tek meshkujt aziatike eshte nje crregullim qe shkakton vdekjen ne gjume si pasoje e takikardise ventrikulare/fibrilacionit ventricular.

### **Takikardia Ventrikulare Polimorfike nga Katekolaminat**

Eshte nje syndrome e pershkruar ne 1978 qe karakterizohet nga sinkopi, takikardia ventrikulare polimorfike qe nxitet nga aktiviteti fizik i shtuar apo emocioni akut ne mungese te demtimeve strukturale te zemres. EKG ja e qetesise eshte e padallueshme

me perjashtim te bradikardise sinusale dhe valeve U prominentne ne disa paciente. Aritmia me e shpeshte eshte takikardia ventrikulare bidireksionale me alterim te aksit te QRS.

### Sindroma e QT se shkurter

E pershkruar per here te pare ne 2000, kjo sindrome karakterizohet nga QT e shkurter (<330 ms), nje incidence e larte e vdekjes se papritur nga takikardia ventrikulare/fibrilacioni ventrikular. Nje tjeter karakteristike dalluese ne EKG jane edhe valet T me maje si ato qe takohen ne hiperkalemi.

### Fibrilacioni Ventrikular Idiopatik

Nje nengrup patientesh me VP hyjne ne kete grup ne literature. Megjithate, eshte e mundur qe ky entitet te mos jete i pavarur por te paraqese nje konglomerat gjendjesh me dukje anatomike makroskopike normale te miokardit ne te cilat crregullimet e ritmit shkaktohen nga anomalite molekulare me baze mutacionet gjenetike – kryesisht nga defektet gjenetike ne proteinat e kanaleve jonike.

## B.Kardiomiopatite Mikse ( gjenetike dhe jo gjenetike )

### Kardiomiopatia e Dilatuar

Keto forma karakterizohen nga dilatimi i ventrikulit dhe disfunkzioni sistolik me trashesi normale te murit te ventrikulit. Zakonisht diagnoza vendoset me ekografi dy dimensionale. KMPD con ne insuficience kardiake progresive dhe ulje te funksionit kontraktues te VM e shoqeruar shpesh me aritmi supraventrikulare, anomali te sistemit percues,trombemboli dhe vdekje te papritur. Eshte nje semundje ne shumicen e rasteve e parikthyeshme me nje prevalence 1:2500 duke e bere shkakun e trete ne patologjite qe kerkojnë transplant kardiak. Shpesh, fillimi eshte ne dekaden e katert te jetes, pa perjashtuar edhe moshat e tjera. Eshte e shoqeruar me shenjat e dukshme te insuficences kardiake dhe invaliditet. Mund te shkaktohet nga agjente infektive, sidomos viruset duke dhene edhe miokardit ( koksaviruset ,adenoviruset,etj); agjentet bakteriale,funget dhe parazitet. Shkaqe te tjera perfshijne perdorimin afatgjate te alkoolit, kemioterapite,perberjet e ndryshme te industrise, metalet etj. Po keshtu nje shkak madhor perbejne edhe semundjet autoimune dhe ato sistemike ; feokromacitoma,semundjet Bekter dhe distrofite muskulore. Semundjet metabolike dhe endokrine mund te jene shpesh shkaku i komplikacioneve kardiake qe cojne ne KMPD.

### Kardiomiopatia Restriktive Primare Jo Hipertrofike

Kjo kardiomiopati eshte nje forme e rralle e semundjes se muskulit dhe nje shkaki insuficences kardiake e shoqeruar me volumnormalapo te ulur te ventrikujve dhe

zgjerim i atriumeve,trashesi normale e murit te ventrikujve, crregullim i mbushjes ventrikulare me baze restriktive dhe funksion sistolik normal.

### C.Kardiomiopatite e Fituara

#### **Miokarditi (kardiomiopatia inflamatore)**

Miokarditi eshte nje forme inflamatore akute apo kronike qe prek miokardin e shkaktuar nga nje sere agjentesh si toksina dhe droga ( kokaina, interleukina 2) apo agjente infeksioze si viruset (coksaviruset, adenoviruset, parvovirus, HIV), bakteret (difteria, meningokoku,streptokoku), rikeciet(tifoja), funget (aspergiloza,kandida) dhe parazitet (Semundja Cages, toksoplazmoza). Nje shkak tjeter jane edhe reaksionet e hipersensitivitetit ndaj medikamenteve si ndaj antibiotikeve, sulfamideve ,antikonvulsanteve dhe anti inflamatoreve.

Fibroelastaza endokardiale eshte nje kardiomiopati e dilatuar ne femije qe eshte pasoje e miokarditit in utero.

Miokarditi zakonisht eshte i zgjidhshem duke dhene nje sherim gradualqe konsiston ne infiltrime qelizore inflamatore duke dhene edeme intersticiale dhe nekroze fokale miocitare duke patur rezultat final fibrozen.

Ky proces patologjik krijon nje substrat te predispozuar ndaj takiaritmive ventrikulare. Ne disa raste, nje miokardit viral mund te shpertheje nje reaksiuni autoimun qe demton miokardin duke dhene demtime citoskeletore mepasoje dilatimin e ventrikulit.

Miokarditi mund te diagnostikohet mbi bazen e ndryshimeve histopatologjike,histokimike apo ndryshimet molekulare. Percaktimi i nje algoritmi te bazuar ne kliniken e semundjes eshte akoma nje sfide. Shpesh pacienti paraqitet me dhimbje gjoksi, dispne eforti, lodhje, sinkop, palpitacione, aritmi ventrikulare dhe crregullime te percimit te shoqeruar me shenjat e insufisances kardiake kongjesteive apo shokut kardiogjen te shoqeruar me dilatim te ventrikulit te majte apo crregullime te kinetikes murore. Kur miokarditi dyshohet klinikisht, nje biopsi endomikardiale mund te percaktoje qarte natyren e semundjes. Analiza e ADN-se rrit se tepermi sakesine diagnostike te biopsies.

#### **Kardiomiopatia e Stresit (“Tako-Tsubo”)**

Kardiomiopatia e stresit e pershkruar per here te pare ne Japoni si “takotsubo,” eshte nje entitet klinik i karakterizuar nga disfunktioni sistolik akut por i rikthyeshem i ventrikulit te majte ne mungese te semundjes aterosklerotike e nxitur nga nje stres i fuqishem. Kjo forme tipike prek me shume grata e moshuara dhe lokalizohet kryesisht ne porcionin distal te ventrikulit te majte ( duke dhene ate qe quhet “balloni apikal”), me pjesen bazale hiperkontraktile. Ndonese imiton infarktin e miokardit me ngritje te ST, ecuria eshte e mire me terapi medikamentoze te zgjedhur.

#### **Forma te tjera**

Kardiomiopatia peripartale (postpartum) eshte nje forme e rralle e kardiomiopatise se dilatuar i shoqeruar me disfunkcion diastolik dhe insuficience kardiake me shkaqe te panjuhura qe shfaqet klinikisht ne trimestrin e trete te shtatzanise ose ne pese muajt e pare pas lindjes. Sot konsiderohet si nje forme e dallueshme nga kardiomiopatite e tjera qe mund te ndikohet per keq nga stresi i shtatzanise. Ky entitet ndodh me shpeshe ne grade pluripare obeze mbi 30 vjec me pre eklampsi. Kjo forme e pazakonte shoqerohet me rikuperim te plote ose pothuaj te plote brenda gjashte muajve ne 50% te rasteve. Ne raste te tjera, mund te shkoje ne drejtim te nje perkeqesimi progresiv,insuficience kardiake dhe nevojes per transplant.

Kardiomiopatia alkoolike eshte nje forme e cila eshte reversibel pas nederprerjes seperdorimit te alkoolit.

## **II.Kardiomiopatite Sekondare**

Ne tabelen e meposhteme, klasifikohen format me te shpeshta te kardiomiopative sekondare.

### **Format Infiltrative**

Amiloidozis (primare, familiare autosomale dominante, senile, format sekondare)  
Semundja Gaucher  
Semundja e Hurler  
Semundja Hunter

### **Format depozituese**

Hemokromatoza  
Semundja Faber  
Semundja e depozitimit te glikogenit  
Semundja Niemann-Pick

### **Format toksike**

Medikamentet, ushqimet e yndyrshme, agjentet kimike

### **Format Endomiokardiale**

Fibroza endomiokardiale  
Endokarditi Löeffler

### **Format inflamatore**

Sarkoidoza

### **Format Endokrine**

Diabeti Mellitus  
Hypertiroidizmi  
Hypotiroidizmi  
Hyperparatiroidizmi  
Feokromocitoma  
Akromegalia

#### **Format kardiofaciale**

Sindroma Noonan  
Sindroma Lentiginoze

#### **Format Neuromuskulare/neurologjikale**

Ataksia Friedreich  
Distrofia muskulare Duchenne-Becker  
Distrofia muskulare Emery-Dreifuss  
Distrofia Miotonike  
Neurofibromatozis  
Skleroza tuberoze

#### **Deficitet nutricionale**

Beriberi

#### **Format Autoimune/Kolagjenoze**

Lupusi eritematoz sistemik  
Dermatomiositis  
Artriti Reumatoid  
Sklerodermia  
Poliarteriti nodoz

#### **Disbalanca Elektrolitike**

#### **Format nga terapia antikanceroze**

Antraciklinat: dokсорубицин (адриамycin), daunорубицин  
Циклофосфамид

#### **Format nga rrezatimi**

## Kardiomiopatia Hipertrofike

### Konsiderata te per gjithshme dhe perspektiva

Kjo permblehdje perben dokumentin e hartuar me konsensusin e ACC dhe ESC. Grupi hartues perbehet nga kardiologe, biologe molekulare te cilet kane nje experience ne njohjen e procesit dhe shfaqeve te kardiomiopative. Paneli eshte fokusuar kryesisht ne manaxhimin e kesaj semundjeje komplekse duke dhene strategji te kuptueshme dhe bashkohore per gjithe nengrupet e pacienteve qe permban kjo patologji me spekter te gjere shfaqjesh klinike. Per shkak te prevalences relativisht te ulet, paraqitjeve te ndryshme klinike, mekanizmave te vdekjes dhe invaliditetit qe shkakton, niveli i evidences qe drejton edhe strategjite e trajtimit shpesh vjen nga studime jo te randomizuara dhe retrospektive. Studime te gjera te randomizuara nuk kane qene te mundura te realizohen. Prandaj, strategjite e trajtimit jane bazuar ne te dhena te marra nga studime te vogla dhe shpesh me karakter observacional. Shpesh, rol ka patur edhe eksperiencia klinike e studjuesve te vecante ne nivel individual. Per kete arsy, ndertimi i algoritmeve strikte diagnozes dhe trajtimet kane qene nje sfide e vazhdueshme. Ne disa situata klinike, vendimarrja eshte bazuar ne gjendjen e pacientit dhe vecorive individuale.

Te kuptuarit e bazes molekulare, dekursit klinik dhe trajtimit te KMPH ka pesuar zhvillim dekaden e fundit. Eshte rritur ndjeshem vemendja per sa i perket heterogenicitetit molekular dhe klinik.

Disa strategji menaxheriale jane te reja dhe ne zhvillim, keshtu ky dokument nuk mund ti perfshje si konkluzione. Gjithashtu, per disa nengrupe te te semuresh, ka pak te dhena per te percaktuar qarte terapine e "arte". Duke patur ne mend keto konsiderata, paneli ka dashur te shkruaje nje dokument i cili eshte jo vetem i kohes, por ka cilesine te jete i rendesishem dhe i referueshem per shume vite.

### Terminologji, percaktimet dhe diagnoza klinike.

Diagnoza klinike e kardiomiopatise hipertrofike vendoset lehtesisht dhe ne menyre te **besueshme me ekografi dy-dimensionale duke** treguar nje hipertrofi te ventrikulit te majte (HVM) – kryesisht asimetrike ne shperndarje qe tregon ne menyre difuze apo edhe segmentare trashje te ventrikulit te majte.

Trashja e murit te VM shoqerohet me nje ventrikul hiperdinamik dhe jo te dilatuar ne mungese te nje semundjeje tjeter kardiake apo sistemike ( si p.sh hipertensioni apo stenoza e aortes ) e afte te shkaktoje hipertrofi. Kjo eshte pavaresisht faktit nese trakti zbrazes i VM ka obstruksion apo jo.

Megjithese kriteri i zakonshem diagnostik eshte trashja e murit mbi 15 mm, korreliimet gjenotip-fenotipike kane treguar se cdo trashje virtuale e murit (duke futur edhe ato te konsideruara normale) eshte e perputhshme me pranine e gjenit mutant te KMPH. Rritja e lehte e trashesise ne nivelet 13 ne 14 mm si pasoje e kardiomiopatise hipertrofike duhet dalluar nga trashja e shprehur fiziologjike ne muret e zemres se atleteve.

Shtimi ne zinxhrin e mjeteve diagnostikues e rezonances magnetike siguron imazhe me qartesi te madhe te gjithe VM sidomos ne rastet kur ekografia deshton te siguroje imazhe te nje kualiteti te mire.

Qe prej zbulimit nga Teare ne vitin 1958, kardiomiopatia hipertrofike eshte “pagezuar” me mjaft emra konfondues qe ne vetvete shprehin heterogenicitetin klinik dhe ecurine e semundjes. Kjo, ka perbere nje pengese per njohjen e plete te patologjise.

Kardiomiopatia hipertrofike tashme perben termin e pranuar gjeresisht sepse pershkruan spektrin e gjere te semundjes pa shkaktuar konfuzion. Obstruksioni i traktit hedhes se VM nuk eshte nje karakteristike fikse e saj si konsiderohej kur kjo patologji njihej ose nje sohej me emrat “kardiomiopati obstruktive hipertrofike”, “stenoze subaortike hipertrofike”.

Shumica e pacienteve ne kushte bazale nuk paraqesin obstruksion te traktit zbrates se VM, ndonese ne mund te paraqesin gradient subaortik dinamik. Vlen te permendet se ndonese obstruksioni i traktit hedhes se VM mungon ne paciente simptomatike dhe asimptomatike, shumica e modaliteve te trajtimit synojne te drejtohen tek pacientet simptomatike me obstruksion.

## Obstruksioni i traktit zbrates se VM

Dallimi midis formes **pa** dhe asaj **me** obstruksion te traktit zbrates se VM ka rendesi klinike. Kjo bazuar ne ekzistencen e gradientit ne kushte qetesie apo sforcimi.

Ne shumicen e pacienteve, strategjite e mjekimit, jane ndertuar mbi bazen e e gjendjes hemodinamike. Gradientet e traktit zbrates jane perjegjes per zhurmen e forte apikale sistolike te shoqeruar me nje bashkesi shenjash klinike, hipertrofine e pjeses bazale te septumit interventrikular, trakin e vogel zbrates te VM dhe valvulen e zgjatur mitrale ne shume paciente.

Obstuksioni mund te jete subaortik ose ne mes te kavitetit te VM.

Obstruksioni subaortik shkaktohet nga levizja anteriore sistolike e fleteve te valvules mitrale dhe kontaktit mid-sistolik me septumin interventrikular.

Rezistenca ne zbrajen e VM ndodh ne prani te shpejtesive te medha te hedhjes kur nje pjese e gjakut mund te kaloje ne sistolen e hershme.

Levizja sistolike anteriore i atribuohet nje efekti terheqes ( fenomeni “Venturi” ) dhe eshte perjegjes jo vetem per obstruksionin subaortik por edhe regurgitimin mitral shoquerues nga mosmbyllja e mire e valvules mitrale e cila drejtohet posteriorisht ne atriumin e majte.

Kur jet-i i regurgitimit mitral drejtohet ne qender ose anteriorisht ne atriumin e majte ose kur kemi te bezme me jet-e te shumte, duhet te dyshojme per anomali te pavarura te valvules mitrale ( si degjenerim miksomatoz, fibroze e fleteve mitrale ose inserim anomal i muskujve papilare).

Ne disa raste, gradientet krijohen kryesisht nga inserimi i muskulit ne regjionin mid-kavitar – zakonisht ne mungese te kontaktit mitral – septal.

Ndonese ka patur diskutime, tashme eshte e pranuar qe gradienti subaortik (30 mm Hg ose me i larte) dhe rritja bashkeshoqueruese e presionit intrakavitar ne VM reflektore pengesen reale te zbrasjes se VM dhe kane rendesi fiziopatologjike dhe prognostike ne pacientet me KMPH.

Keshtu, obstruksioni i traktit zbrazes se VM eshte nje parakallezues i pavarur i progresimit te semundjes,(risku relativ krahasuar me pacientet pa obstruksion eshte 2.0 ) ne shfaqjen e shenjave te Insuficiencies Kardiake NYHA III ose IV dhe vdekjes nga insulti ( risku relativ krahasuar me pacientet pa obstruksion 4.4)

Gjithsesi, edhe kur gradienti ishte me i larte se 30 mm Hg, gjasat e vdekjes dhe simptomatika e shkaktuar nga obstruksioni i traktit zbrazes nuk rritej me shume.

Pasojat e lidhura me pranine kronike te obstruksionit te traktit zbrazes theksohen edhe nga stresi i rritur qe ushtrohet ne murin e VM, iskemise miokardiale dhe vdekjes qelizore dhe zevendesimit me ind fibrotik. Prandaj prezenca e obstruksionit ne trakin zbrazes te VM justifikon nderhyrjen per zvogelim deri ne eliminim te gradienteve subaortike ne pacientet simptomatike qe jane refraktare ndaj mjekimit medikamentoz. Obstruksioni eshte dinamik : shkalla e obstruksionit eshte e ndryshueshme dhe varet nga një numer alteracionesh fiziologjike si p.sh ngrenia e nje vakti te rende apo marrja e nje sasie alkooli. Pragje te ndryshme numerike te gradienteve jane propozuar per ndarjen e pacienteve ne nengrupe por kjo ndarje strikte vetem ne baze te gradienteve eshte e veshtire per shkak te ndryshimit te menjehersh hem te ketyre te fundit ne individe te vecante. Gjithsesi, nje ndarje ne nengrupe eshte e llogjikshme ku kjo bazohet ne gradientet maksimale momentale e matur me dopler te vazhdueshem : 1) gradienti ne kushte bazale qetesie me i madh se 30 mm Hg (2.7 m/s i matur me Doppler), 2) obstruksion i provokuar me gradient me te vogel se 30 mm Hg ne qetesи dhe mbi 30 mm Hg ne effort. 3) Gradient jo obstruktiv kur eshte me i vogel se 30 mm Hg si ne qetesи ashtu edhe ne effort. Mbi bazen e nje konsensusi klinik, gradientet e traktit zbrazes te VM maten ne menyre jo invazive me Dopler te vazhdueshem ne Ekokardiografi, duke evituar nevojen e kateterizimeve te vazhdueshme.

Eshte e rendesishme te nenvizohet qe jane propozuar shume procedura per te zbuluar gradientet e induktuar ne ekografi, kateterizim e prove efforti. Megjithate, ka munguar nje standartizimi korrekt i ketyre nderhyrjeve dhe disa prej tyre jane konsideruar si gjendje jo fiziologjike.

Prova ushtrimore e kombinuar me ekografine eshte perdorur per te percaktuar gradientet e provokuar me ushtrim per nje vleresim me te mire te grades se patologjise dhe perben metoden me fiziologjike pasi vete simptomat e KMPH jane te provokuara nga ushtrimi ose sforcimi fizik.

Administrimi intravenoz i dobutamines, eshte i padeshirueshem sic do te diskutohet edhe me pas.

## Diagnoza molekulare dhe konsiderata mbi gjenetiken

KMPH eshte nje semundje e trasheguar si nje gjen autozomal dominant I shkaktuar nga mutacioni I secilit nga 10 genet qe kodojne komponentet proteinike te sakromerit kardiak. Shfaqet e ndryshme klinike mund te shihen sin je entitet I vetem dhe nje crregullim primar I sakromerit.

Tre nga genet mutande jane perjegjes per shumicen e rasteve me KMPH—zinxhiri I rende beta-miozines, proteina C lidhese e miozines dhe troponina T. keto forma perbejne rreth 50% te te gjitha rasteve.

Shprehja fenotipike e kardiomopatise hipertrofike ( hipertrofia e VM ) eshte pasoje jo vetem e mutacionit shkaktar por edhe e faktoreve te ambientit dhe gjeneve modifikues. Efekti i ketyre te fundit, mbetet per tu vleresuar pasi nuk ka studime te mirefillta por supozime qe vijne nga shumllojshmeria fenotipike e individuve te prekur te se njejtë familje.

Si pasoje, e kompleksitetit te biologjise molekulare te hipertrofise, shprehja e fenotipit mund te influencoitet nga shume gene.

Ka nje konsensus ne rritje per sa i perket rolit te gjenetikes ne gjenezen e anomalive elektrofiziologjike qe shoqerojne hipertrofine e VM. Keshtu per shembull , nje risk i rritur per fibrilacion atrial, eshte i lidhur me zinxhiret e rende te beta-miozines.

Studimet molekulare gjenetike te dekades se fundit, nenvizojne dhe japosn informacion te rendesishem per te kuptuar thelbin dhe heterogeniciteten klinik dhe gjenetik te kesaj patologjije duke bere te mundur diagnostikimin e individuve ne fazen preklinike te cilet jane te prekur nga mutacioni gjenetik por pa shenja fenotipike.

Bazuar ketu, prevalanca ne populete e kesaj patologjije mund te jetë me e larte se ajo e pershkruar 1:500 (qe bazohet ne shprehjen fenotipike te matur me ekografi)

Ne vleresimin klinik te individuve, eshte e detyrueshme te informohen per natyren familjare dhe transmesionin autozomik dominant te saj.

Jo te gjithe individet me defekt gjenetik kane shprehje te KMPH gjate gjithe jetes, dhe disa here, anomalite e EKG-se apo shenjat e disfunktionaliteteve diastolik te vleresuar me Doppler indor mund te paraprijne shfaqjen fenotipike ekografike; kjo eshte me e shpeshte tek te rinte. Studimet klinike dhe molekulare kane demostruar se nuk ka nje minimum te trashjes se VM te shoqeruar me pranine e nje gjeni mutand perjegjes per KMPH. Per shembull, eshte e shpeshte qe ne femije me te vegjel se 13 vjec, ka mutacione te heshtura pa shenja te hipertrofise se VM ne ekografi.

Me shpesh, rimodelimi i VM me shfaqje spontane te hipertrofise se ndodhet i shoqeruar me nje rritje te perspektuar ne vitet e adoloshences dhe me shprehje morfollogjike pas moshes 17-18 vjec.

Kriteret te reja diagnostike,bazuar ne studime gjenotip-fenotipike kane treguar se penetranca jo e plete dhe shfaqja klinike pa (ose me hipertofi minimale te VM) mund te ndodhet ne individet adulte.

Kjo ka cuar ne rishikimin e teorise sipas se ciles “*nje ekogardiografi normale ne nje person adult pasi ka kaluar moshen e rritjes , perjashton prekjen gjenetike te nje pjestari te familjes ku karaste me kardiomopati hipertrofike*”.

Shfaqja e vone e semundjes ne disa individet, dikton pamundesine e konkluzioneve te sigurta lidhur me perjashtimin e semundjes ( mutacionit gjenetik) tek personat asimptomatike ; edhe kur ekografia eshte normale.

Procesi i “screening”te linjes se pare te te afermeve duhet inkurajuar si perqasje e drejtë kur një pjestar i familjes eshte i prekur nga semundja.

Kur diagnoza e bazuar ne studimin e ADN nuk eshte e mundur, duhet qe personat e familjes dhe te afermit tu nenshtrohen EKG-se, ekokardiografise, dhe ekzaminimit klinik një here ne vit gjate viteve te adoloshences (12 -18 vjec).

Tek personat adulte mbi 18 vjec, “screening” duhet bere ne intervale 5 vjecare.

Tek personat nen 12 vjec, nuk rekomandohen “screening” me perjashtim te rasteve kur personi ka histori familjare risku te larte apo kur eshte i angazhuar ne aktivitete sportive kompetitive.


Personat e prekur te identifikuar nepermjet “screening” ndiqen cdo një vit sic pershkruhet ne pikezimin e stratifikimit te riskut.

Testi i ADN eshte metoda definitive per te percaktuar diagnozen e kardiomiopatise hipertrofike. Momentalisht ka pengesa per lidhjen e studimeve gjenetike me praktiken klinike dhe strategjite rutine te trajtimit. Keti perfshihen heterogeniciteti i rendesishem gjenetik, frekuencë e ulet e mutacioneve gjenetike,veshtiresite metodologjike per gjetjen e mutacionit per gjegjes per semundjen, kohen dhe kostot e nevojshme per diagnostikim.

Sot, kerkimet gjenetike jane kufizuar ne nivel laboratoresh me orientim kerkimor.

Trajtimi gjenetik, paraqet ne potencë probleme te medha ,pasi kardiomiopatia hipertrofike eshte një patologji qe percillet ne menyre dominante autozomale dhe mutacionet kodohen ne një zinxhir te vetem proteinik. Keshtu terapia duhet te jetë e afte te “gjurmoje”kete zinxhir. Per me teper, per zgjedhja e pacienteve do te ish komplekse, pasi disa forma te semundjes kane pritshmeri te mire jetgjatesie dhe mungese simptomash.

Grupi i perfituesve potenciale do te limitohej tek moshat e reja me risk te larte te identifikuar para fillimit te hipertrofise se VM.



**Fig. 1** Paraqitja klinike dhe strategjite e trajtimit per nengrupet e pacienteve Brenda spektrit te gjere te kardiomiopatise hipertrofike (KMPH)  
 DDD = peisim ne dy dhoma, atrium ventrikul, KMPH = kardiomiopati hipertrofike; FA = fibrilacion atrial; VP = vdekje e papritur; IK = Insuficience kardiake.

## Konsiderata te pergjithshme ne lidhje me historine natyrore dhe ecurine klinike.

Kardiomiopatia hipertrofike eshte semundje unike me potencial per shfaqje klinike ne cdo faze te jetes – nga femijeria ne moshe te avancuar.

Ecuria klinike eshte e ndryshme dhe pacienti mund te jete i qete per shume kohe. 25% e pacienteve arrijne nje jetegjatesi mbi 75 vjec. Shume paciente te tjere mund te kene ecuri me ngjarje te shumta ; insulte embolike, insuficience kardiake dhe deri vdekje te papritur. Kardiomiopatia hipertrofike mund te jete shkak i insuficences kardiake ne femije dhe shfaqja e IK ne kete moshe eshte nje parakallzues i ecurise jo te mire.

Ne pergjithesi, ngjarjet kardiake shkojnë sipas nje shtigjeve te paraqitura ne ne figuren 1 dhe 2 duke diktuar edhe strategjite e mjekimit.

- 1) risk i larte per vdekje te papritur
- 2) simptomatike progresive si pasoje e dispense ne efort, dhimbje gjoksi ( tipike apo atipike ne natyre) dhe demtim te vetedijes deri ne gjendje sinkopale ne prani te nje funksioni te mire te VM.

- 3)Perparim ne drejtim te insuficences kardiake se avancuar kongjestive ( faza terminale ) me rimodelim te VM dhe disfunkcion sistolik.
- 4) komplikacione pasoje e FA si insulti embolik.

Megjithate, vleresim i plete i implikimeve klinike te kardiomiopatise hipertrofike kerkon nje vemendje me te mire te karakteristikave te secilit pacient. Si ralle ndonjehere ne praktiken klinike te semundjeve kardiovaskulare, evidenca dhe materialet mbi kardiomiopatine hipertrofike vjen nga nje numer i kufizuar qendrash terciare ne Ameriken e Veriut dhe Europe ku kemi nje numer te konsiderueshem pacientesh me risk te larte te cilet ne nje menyre apo nje tjeter ndikojne ne gabimin e perzgjedhjes. Ne anen tjeter, pacientet klinikisht stable ose pacientet e moshuar jane nen perfaqesuar ne studimet e bera.

Varesia nga frekuencat e cituara (3-6% per vdekjet e shkaktuara nga kardiomiopatia hipertrofike) mund te kete cuar ne nje mbivleresim te riskut te per gjithshem dhe impakti i kesaj semundjeje mbi pacientet duke cuar ne nje koncept te gabuar qe "kardiomiopatia hipertrofike eshte nje semundje me ecuri pandryshuesherisht te keqe, pasoja kritike dhe nevoje per intervent madhor".

Raportimet e fundit nga qendrat jo terciare te bazuara ne paciente qe perzgjedhur ne komunitet jane te dhena qe paraqesin ne menyre me realiste ecurine e semundjes. Keto raportime, citojne perqindje mortaliteti me te ulet ; rreth 1% me nje mbijetese jo shume te ndryshme nga ajo e popullates se per gjithshme ne USA.

Megjithate, brenda spektrit te gjere te pacienteve, ka nga ata qe kane vlera mortaliteti shume me te larta se ajo e permendor me siper duke shkuar deri ne 6% ne vit.


Kardiomiopatia hipertrofike nga mutacionet proteinike te sakromereve mund te ndodhet edhe ne moshat e vjetra dhe duhet dalluar nga nga semundja hypertensive e zemres apo ndryshimet e varura nga mosha.

Percaktuesit e mbijeteses ne paciente me kardiomiopati hipertrofike jane te papercaktuar mire. Sot, te dhenat gjenotipike disponohen vetem per nje numer te kufizuar pacientesh te moshuar, me mutacione ne proteinen C lidhese te miozines qe perben shumicen e rasteve. Pacientet e vjetra me kardiomiopati hipertrofike kane nje shkalle te lehte te hipertrofise se VM dhe mund te mos kene simptoma te shprehura. Disa kane gradiente subaortike te medhenj te qetesise te shkaktuari kryesisht nga Leviza Anteriore Sistolike ne kushte te fletave normale mitrale te zhvendosura anteriorisht nga grumbullimi kalcik posterior ne anulusin mitral ne nje trakt zbrazes te vogel te VM.

Diagnoza e sakte e kardiomiopatise hipertrofike ne paciente te moshuar hipertonike eshte e veshtire te vihet; sidomos ne kushtet e kur trashesia e VM eshte nen 20 mm dhe nuk kemi Levizje Anteriore Sistolike. Ne mungese te analizes gjenetike, nje hipertrofi e shprehur e VM disproporcionele me nivelin apo graden e HTA do te sugjeroje kardiomiopati hipertrofike ne rast se kemi nje patern te pazakonte te hipertrofise se VM ose nje obstruksion te TZ te VM ne qetesë.

Jo rralle, kardiomiopatia hipertrofike bashkekziston me kondicione te tjera kardiak si HTA dhe/ose SAK. Ne keta paciente, trajtimi i kardiomiopatise hipertrofike duhet te konsiderohet ne menyre te pavarur nga semundjet bashkeshoqueruese. P.sh, kujdes duhet treguar per sa i perket perdonimit te ACE inhibitoreve per kontrollin e HTA ne

prani te obstruksionit te TZ te VM qe shoqeron KMPH apo pamundesine per te perjashtuar SAK ne paciente me KMPH dhe angina pektoris. Si permblehdje, mund te themi se eshte me e udhes ta shohim KMPH si nje semundje komplekse, e afte te prodhoje pasoja te rendesishme klinike dhe vdekje te parakohshme ne disa paciente. Tek te tjere, mund te mos kemi ndikim per sa i perket jetegjatesise krahasuar me popullaten ne per gjithesi dhe shkalla e invaliditetit mund te jete e ulet apo edhe te mungoje. Mjaft individe te prekur nga KMPH mund te mos kerkojne trajtim per pjesen me te madhe te kohes.



**Fig. 2** Shtigjet kryesore te progresionit te semundjes ne kardiomiopatine hipertofike. Trashesia e shigjetes tregon perafersht frekuencen me te cilen ky shteg haset ne popullaten e pacienteve me kardiomiopati hipertrofike

## Simptomatika dhe strategjite e menaxhimit farmakologjik

Lehtesimi dhe minimizimi i simptomave te insuficencies kardiak (fig 1 ) eshte qellimi kryesor ne patientet me KMPH

Terapia farmakologjike ka qene edhe hapi i pare per lehtesimin e simptomave invalidizuese te dispense se efortit (me apo dhimbje gjoksi) dhe permiresimin e aftesise ushtrimore prej 35 vitesh kur u prezantuan beta blokuesit.

Shpesh, medikamentet jane e vetmja zgjidhje per patientet pa obstruksion te TZ te VM ne qetes apo efort qe perbejne nje pjese te mire te popullates se pacienteve me KMPH. Vertete, eshte nje konsensus i per gjithshem qe ne momentin e shfaqjes se intolerances ushtrimore te fillohet mjekimi medikamentoz, pavaresisht numrit te paket te studimeve te randomizuara qe perkrahin kete perqasje. (Fig. 1).

Dispnea e efortit dhe invaliditeti (shpesh i shoqeruar me dhimbje gjoksi), vertigo, presinkop dhe sinkopi shpesh ndodhin ne kushtet e nje funksioni sistolik te mire dhe nje ventrikuli normal per sa u perket permasave.

Simptomat u atribohen ne nje shkalle te madhe disfunkzionit diastolik me demtim te mbushjes nga cregullimi i relaksimit ventrikular per shkak te rritjes se rigiditetit te murit te VM. Kjo con ne rritje te presioneve te AM dhe te atij telediastolik ne VM. ( me ulje te hedhjes kardiake ), kongestionin pulmonar dhe demtim te performances ushtrimore me ulje te konsumit te oksigenit ne kulm te ushtrimit.

Fizpatologja e ketyre symptomave te lidhura me insufisencen diastolike mund te kombinohet edhe mekanizma te tjere te rendesishem si iskemia miokardiale, obstruksioni i TZ te VM e lidhur me regurgitimin mitral dhe fibrilacionin atrial. Keshtu mjaft paciente mund te perjetojne simptoma te lidhura me disfunkzionin diastolik apo iskemi miokardiale ne mungese te obstruksionit te TZ te VM apo hipertrofise se rende. Te tjere, ( ata me obstruksion te TZ) jane me te invalidizuar nga rritja e presioneve te mbushjes se VM dhe regurgitimit mitral shoquerues sesa nga disfunkzioni diastolik. Dhimbjja e gjosit ne mungese se SAK mund te jete tipike si angina pektoris apo atipike ne natyre.

Shpesh, dhimbjet e gjoksit i atribohen goditjeve te iskemive miokardiale te dokumentuara me gjetjet e cikatriceve ne autopsi, defekteve fikse apo te rikthyeshme te perfuzionit ne rezonancen magnetike, clirimit te laktateve gjate peisimit atrial dhe demtimit te kapacitetit dilatues te arterieve koronare. Ajo eshte propabilisht pasoje e mikrovaskulatures anormale qe konsiston ne trashje te mureve te arteriolave koronare dhe ngushtim te lumenit te tyre dhe/ose nje disbalance midis mases se madhe te rritur te VM dhe rrjedhes koronare. Shpesh, SAK qe mund te shoqeroje nje KMPH, nenvereresohet duke ja atribuar dhimbjet e gjoksit kesaj te fundit. Prandaj, koronarografia eshte mjeti diagnostic i preferuar per te sqaaruar nje situate te tille ne rastet kur pacienti eshte mbi 40 vjec qe kane faktore risku ose kur probabiliteti per te patur SAK gjykohet i larte. Kjo duhet bere perpara cdo nderhyrjeje invasive te indikuar per KMPH.

### **Agjentet beta bllokues**

Beta-bllokuesit jane agjente inotrope negative qe jane perdorur tradicionalisht ne pacientet me KMPH ; me dhe pa obstruksion te TZ te VM. Megjithate, gjykimi perfundimtar ne lidhje me perdonimin e tyre eshte i veshtire per shkak te ndryshuesherise se simptomatikes me kohen.

Prova ushtrimore, ka dhene informacion te sakte per shenjestrimin e pacienteve qe meritorjne kete terapi apo edhe momentin e fillimit te medikamentit apo rregullimin e dozave. Pergjigjja ndaj mjekimit eshte variable dhe zgjedhja e medikamentit eshte opsonale dhe subjekt i eksperiencave individuale.

Propanololi ka qene medikamenti i pare qe eshte perdorur. Kohet e fundit, jane futur ne loje medikamentet kardioselektive.Ka mjaft raportime per rritjen e aftesise ushtrimore dhe permiresimin e simptomatikes me perdonimin e propranololit ne doza deri 480 mg/d ; si ne paciente me, ashtu edhe ne ata pa obstruksion te TZ te VM. Gjithsesi, edhe dozat e moderuara te beta-bllokuesve mund te ndikojne ne procesin e rritjes dhe te krijojnë depresion apo te ulin performancen ne shkolla ne femije e adoloshente.

Prandaj, ky nengrup pacientesh kerkon monitorim nga afer. Eksperienca ka treguar se

dozat standarte te beta-bllokuesve mund te minimizojne simptomat dhe vonojne lindjen e gradienteve ne TZ – kjo me e shprehur ne efort. Megjithate, ka pak te dhena qe mbeshtesin kete perfitim nga beta-bllokuesit ne kushte te qetesise. Prandaj, beta-bllokuesit jane te perzgjedhur ne paciente me gradiente dhe obstruksion te TZ ne eforre. Efektet pozitive te beta-bllokuesve duket se lidhen me teper me uljen e frekuences, rritjen e diastoles dhe relaksimit. Keta agjente, ulin kontraktilitetin e VM dhe ulin kerkesen per O<sub>2</sub>, duke reduktuar iskemine mikrovaskulare.

### **Verapamili**

**N**e 1979, verapamili u perdor si nje inotrop tjeter negativ ne trajtimin e KMPH - ne formen *me*, dhe *pa* obstruksion. Raportimet mbi perfitimet kane qene te shumta duke perfshire edhe pacientet me komponentin e dhimbjes se gjoksit. Ne doza deri 480 mg/d ka efekte te favorshme mbi simptomatiken duke permiresuar relaksimin ventrikular dhe mbushjen e VM si dhe ulur kontraktilitetin e VM. Pavec konstipacionit te lehte dhe renies se flokeve verapamili ka potencial per efekte anesore te rendesishme deri ne shkaktimin e vdekjes ne disa paciente me KMPH me simptomatike te shprehur (ortopne, dispne nokturne ) dhe disa paciente hipertensive dhe obstruksion te shprehur te TZ te VM. Efektet negative hemodinamike lidhen me predominimin e efektit vazodilatator mbi ate inotrop negativ. Kjo, con ne rritje te shkalles se obstruksionit, edemes pulmonare dhe shokut kardiogjen. Per keto arsy, administrimi i tij duhet bere me kujdes ne pacientet me obstruksion te TZ ne qtesi dhe teka ata simptomatike te shprehur. Disa studjues nuk inkurajojn perdonimin e ca-bllokuesve ne KMPH dhe rekomandojne Disopiramidin (te shoqeruar me beta-bllokues) tek pacient simptomatike. Ne rastin e pacienteve simptomatike (me dispne) zgjedhja e mjaft studjuesve eshte beta bllokuesi perkundrejt Ca bllokuesit. Verapamili eshte nje alternative tek pacientet asmatike dhe tek ata ku deshton beta-bllokuesi. Tani per tani, nuk ka evidence per perdonimin e kombinuar beta me ca bllokues.

### **Disopiramidi**

Antiaritmiku i klases I-A dhe inotropi negativ qe eshte futur per here te pare ne 1982 ne skemen e trajtimit te KMPH me obstruksion te TZ te VM. Ne doza 300-600 mg/d jane pare permiresime te simptomatikes ne pacientet e invalidizuar me obstruksion te TZ te VM si pasoje e uljes se shkalles se Levizje Anteriore Sistolike, shkalles se obstruksionit dhe volumit regurgitant mitral. Meqenese disopiramidi perspejton percimin atrio-ventrikular duke rritur frekuencen ventrikulare gjate fibrilacionit atrial, kerkohen doza te vogla shoqeruese beta bllokuesi. Per shkak te potentialit pro-aritmogen, duhet monitoruar zgjatja e QT. Gjithashtu, disopiramidi ka efekte anesore ne paciente me kardiomiopati hipertrofike pa obstruksion te TZ te VM. Kjo kushtezon edhe perdonimin e tij ne ato raste pa obstruksion te TZ te VM kur ka deshtuar apo kunderindikohet verapamili apo beta bllokuesi. Per momentin, perdonimi i sotalolit dhe diltiazemit nuk mbeshtetet nga informacione te mjaftueshme. Agjentet diuretike mund te perdoren me kujdes ne rastet me obstruksion jo te rendesishem te TZ. Meqenese shume paciente

kane disfunktional diastolik dhe kerkorre presione te larta mbushese te VM per te realizuar nje mbushje normale, perdonimi i diuretikeve duhet te jetë i kujdeshme.

Nifedipina, per shkak te vete vazodilatatore, mund te rezultojë e demshme sidomos ne paciente me obstrukcion te TZ te VM.

Kombinimi i disopiramidit dhe amiodaronit apo kinidines dhe verapamilit duhen shprehur per shkak te potencialit te rritur proaritmik. Administrimi i nitroglycerines, ACE-Inhibitoreve apo digitalikeve jane zakonisht te kundrainduar ne paciente me KMPH me obstrukcion te TZ te VM. Ne pacientet me insuficience kardiake te shprehur dhe refraktare ndaj mjekimit, dhenia e amiodaronit duhet bere me kujdes ( sidomos kur jepet ne doza mbi 400 mg/d ).

### **Medikamentet e fazeve terminale**

Nje kategori e vogel e pacienteve me KMPH jo obstruktive zhvillojne disfunktional sistolik dhe shenja te IK severe te shoqeruar me rimodelim te VM dhe hollim te mureve me dilatim te kavitetit. Kjo ecuri ndodh ne rreth 5% te pacienteve dhe njihet si "faza terminale" ose "faza e dilatuar". Koncepti i trajtimit te tyre ndryshon nga pjesa tjeter e pacienteve dhe involvon perdonimin e ACE-inhibitoreve/ARB, diuretikeve, digitalit, beta-blokueve dhe spironolaktonit.

Nuk ka evidence qe beta blokuesit te shtojne ndonje perfitim ne trajtimin e kesaj kategorie te semuresh (ne ndryshim nga eksperianca ne KMPD dhe SAK). Perfundimisht, pacientet e stadiit terminal jane kandidate per transplant kardiak dhe perbejne nengrupin kryesor ne diapazonin e gjere te KMPH qe mund te perfitojne nese ky opsjon merret ne konsiderate.

### **Pacientet asimptomatike**

Te dhenat nga studimet e medha dhe ato gjenotipike ne familjet e prekura, sugjerojnë se shumica e pacienteve me KPMH; perfshire edhe ata qe nuk kane dijeni per semundjen, jane pa simptoma apo me simptoma te lehta. Pjesa me e madhe e tyre nuk kane nevoje per trajtim.

Ndersa shumica e pacienteve asimptomatike nuk kerkorre trajtim, ne disa prej tyre hasemi me dilema per shkak te moshes se tyre te re dhe komponentit profilaktik per te parandaluar vdekjen e papritur apo progresimin e semundjes.

Terapia medikamentoze profilaktike tek asimptomatiket apo ata me simptoma te lehta per parandalimin apo vonesen e shfaqjes se simptomave dhe permiresimit te prognozes ka qene objekt debate per shume vite, por akoma mbetet e bazuar ne te dhena empirike dhe eksperienca qendrash. Kjo gje, mbetet akoma e pazgjidhur per shkak te numrit relativisht te vogel te pacienteve ne dispozicion dhe frekuences se vogel te efekteve anesore apo atyre kercenuese qe sherbejne edhe si pikemberritje te references ne studime. Per me teper, eshte rritur ndjeshmeria qe ka te beje me jetegjatesi te pritshme normale per nje nengrup te konsiderueshem patientesh me KMPH. Ne per gjithesi, trajtimi me synim vonesen apo parandalimin e fazeve

simptomatike te semundjes ka te beje me lehtesimin e obstruksionit te TZ te VM dhe kontrollimin apo dominimin e FA nepermjet terapive medikamentoze. Sot, terapia eshte e justifikuar ne paciente me risk te larte per vdekje te papritur. ( sic eshte perspektuar tek Stratifikimi i Riskut dhe Vdekja e Papritur). Efikasiteti i trajtimit empirik me beta-blokues, verapamil ose disopiramid per te vonuar lindjen e simptomave dhe modifikuar pozitivisht kursin klinik te semundjes ne paciente te rinj asimptomatike me obstruksion te rendesishem dhe gradiente te larta ( 75 – 100 mm Hg ) eshte akoma per tu vleresuar.

### **Profilaksia per endokarditin infektiv**

Ne KMPH, ka nje risk te vogel per endokardit bakterial i cili shihet me teper ne pacientet me obstruksion te TZ te VM ne kushte qetesie ose tek ata me semundje bashkeshoquese te valvules mitrale. Preket kryesisht fleta e trashur anteriore mitrale , ndonese jane raportuar edhe raste me vegjetacion ne piken e kontaktit septum-flete mitrale ose edhe ne valvulen e aortes. Prandaj, rekomandimet e AHA duhet te aplikohen ne pacientet me obstruksion te TZ te VM ne kushte qetesie dhe eforti ne momentin e kirurgjive dentare apo atyre te planifikuara qe kane risk infekzioni.

### **Shtatzania**

Nuk ka evidence qe pacientet me KMPH kane risk me te larte gjate shtatzanise dhe aktit te lindjes. Mortaliteti absolute maternal eshte teper i ulet ( ndonese pak me i larte se popullata e per gjithshme ) dhe duket te jete e kufizuar tek grate me profil te larte risku. Keta paciente, duhet te jene ne nje kujdes mjaft te larte gjate lindjes. Pjesa tjeter e grave, mund te lindin ne menyre natyrale pa patur nevoje per nderhyrje kirurgjikale.

### **Opsione terapeutike per pacientet qe nuk i pergjigjen terapise medikamentoze.**

Ne disa paciente, terapia medikamentoze nuk ka sukses ne kontrollin e simptomave dhe cilesia e jetes behet e papranueshme tek pacienti. Ne kete moment te kursit klinik te semundjes, strategja ka te beje nese ka pao jo obstruksion te TZ te VM. ( fig 1 ).  
Kirurgjia: nje nengrup i vogel por i rendesishme i pacienteve me KMPH ( qe jane rreth 5% te pacit e preferuar dhe rreth 30% e atyre te referuar ne qendra terciare) jane candidate per kirurgji. Keta paciente kane gradiente te rendesishme te TZ te VM ( > 50 mm Hg), te matur me doppler te vazhdueshem si ne kushte qetesie ashtu edhe ne effort. Per me teper, keta paciente kane simptoma te renda invalidizuese ; zakinisht dispne ne efort dhe dhimbje gjoksi duke u klasifikuar si IK NYHA III-IV dhe jane refraktare ndaj terapise medikamentoze. Gjate 40 viteve te fundit, duke u bazuar ne eksperienca e disa qendrave ne gjithe boten, mioektomia septale ( e njojur ndryshe edhe si procedura Morrow) eshte percaktuar te jete procedura e provuar si e suksesshme me lirimin e obstruksionit te TZ te VM dhe standarti i arte si per adultet ashtu edhe per femijet me KMPH dhe refraktaritetit ndaj perdonimit te medikamenteve. Kjo nderhyrje

duhet te kufizohet vetem ne qendra me eksperience ne kete procedure. Procedura kryhet nepermjet aortotomise dhe konsiston ne rezeksionin e nje pjese te percaktuar mire muskulare nga septumi proksimal ( 5-10 g), nga baza e valvules se aortes deri distalisht gjurmave te fleteve mitrale (rreth 3 - 4 cm), duke zgjeruar keshtu TZ te VM duke pakesuar simptomat ne nje numer te madh pacientesh dhe shmangur levizjen sistolike anteriore. Kjo con ne normalizimin e presioneve sistolike te VM duke minimizuar edhe regurgitimin mitral dhe reduktuar presionin telediastolik ne VM. Nje lethesim i tille i shpejte i gradientit (ne kundershtim me ate te ngadalshem nga ablacioni me alkool i septumit ) eshte vecanerisht superior ne paciente te invalidizuar ne menyre severe. Disa kirurge, kane perdonur nje tekniqe me te thelle mioektomie duke e zgjeruar rezeksionin septal me distalisht sesa metoda standarte Morrow ( 7-8 cm nga valvula e aortes poshte deri ne nivel te mm papilare ). Per me teper, m. papilar anterolateral mund te shkeputet nga lidhja me murin lateral te VM per te rritur levizshmerine dhe reduktuar mbledhjen anteriore te aparatit mitral. Ne menyre alternative, riparimi mitral apo edhe zevendesimi eshte perdonur ne paciente te vecante me regurgitim mitral sever nga anomalite intrinseke te aparatit valvular ( si p.sh valve miksomatoze). Me pare, disa kirurge kane konsideruar si superiore ne paciente te vecante zevendesimin valvular kur septumi basal anterior ne zonen e rezeksionit eshte i holle (nen 18 mm) dhe rezeksioni muskular gjykohet te jete nje risk per performim septal apo kur rezultati hemodinamik i pritshem eshte i pakenaqshem.

Sot, disa qendra te specializuara nuk rekomandojn zevendesimin valvular edhe kur septumi eshte relativisht i holle; rezeksion i kujdeshem eshte per to procedura e zgjedhur.

Plastika valvulare mitrale e kombinuar me mioektomi eshte nje zgjidhje ne paciente me aparat mitral te demtuar rende. Ne disa raste (sidomos tek femijet) mund te kemi obstruksion te TZ te VD si pasoje e hipertrofise se ekzagjeruar te trabekulave – ne keto raste rezeksioni i muskulit con ne ulje te gradienteve. Mioektomia e izoluar sot kryhet ne mjaft qendra dhe ka nje mortalitet te ulet. Kuptohet qe ky risk eshte me l larte tek te moshuarit dhe ata me patologji bashkeshoqeruese dhe hypertension pulmonary.

Perfitimi simptomatik lidhet se tepermi me uljen/shuarjen e gradienteve dhe minimizimin e regurgitimit mitral duke normalizuar presionet telediastolike ne VM. Kjo con ne nje normalizim te mbushjes se VM dhe reduktim te iskemise. Ne paciente nen 45 vjec, pas mioektomise mund te kemi kthim ne ritem sinusal si pasoje e uljes/zvogelimit te permasave te atriumit te majte.

Pacientet ku simptomat refraktare ndaj mjekimit jane lidhur ne menyre te padiskutueshme me gradiente te larta te TZ ne eforte (kur obstruksioni ne qetesи eshte i lehte ose mungon) zakonisht perfitojne gjithashtu nga mioektomia. Dukuria e levizjes Sistolike Anteriore dhe rifitimi i gradienteve ne TZ, eshte mjaft i rralle pas procedures se suksesshme te miptomise; si ne adulte ashtu edhe tek femijet dhe nevoja per rinderhyrje per te reduktuar gradientin mbetes eshte shume e paket ne qendrat me eksperience ne kete procedure. Me marreveshje, kirurgjia nuk rekomandohet ne paciente asimptomatike apo me simptoma te lehta me KMPH obstruktive per nje numer arsyesh:

1) Efekti i kirurgjise mbi jetegjatesine eshte akoma ne diskutim, megjithe raportet qe flasin per nje permiresim te mbijeteses se vone pas miptomise krahasuar me kursin klinik te pacienteve te paoperuar dhe te trajtuar ne menyre medikamentoze kur keta kane simptomatike te shprehur;

2)megjithe riskun e ulet operator, ne disa paciente ky risk mund te kaloje ate qe shkakton vete semundja;

3)Obstruksioni i TZ te VM shpesh eshte kompatibel me nje jetegjatesi qe i afrohet asaj te popullates se per gjithshme;

4) Ka pak te dhena qe clirimi kirurgjikal i obstruksionit "shuan" riskun per progresion drejt fazes terminale, e cila eshte nje pasoje e pavarur e semundjes.

Ndonese nuk ka evidence, ka nje sugjerim nga studimet retrospective jo te randomizuara qe clirimi kirurgjikal i obstruksionit mund te reduktoje mortalitetin afatgjate dhe eventualisht vdekjen e papritur.

Duhet theksuar se kirurgjia nuk konsiderohet si kurative por nje procedure qe synon permiresimin e cilesise se jetes dhe aftesine funksionale. Nje perjashtim perbejne patientet e rinj asimptomatike apo me simptoma te lehta me gradiente sinjifikante (75 – 100 mm Hg ose shume ne qetes). Ka nje mungese te dhenash ne kete nengrup por nuk eshte e pamenduar te rekomandosh kirurgjine ne subjektet e rinj, edhe kur nuk jane simptomatike kur ka obstruksion te rendesishem te TZ te VM.

#### **Perqasje shtese per te lethesuar obstruksionin e traktit zbrates te ventrikulit te majte dhe simptomat.**

Miotomia ventrikulare septale eshte indikuar dhe kufizuar ne qendra te medha me eksperience ne kete procedure. Megjithate, disa paciente mund te mos kene akses ne qendra te tilla per shkak te largesise gjeografike; ose mund te mos jene favorite per kirurgji per shkak te patologjive bashkeekzistuese – sidomos moshes se avancuar, kirurgji te meparshme kardiak, apo motivim personal te pamjaftueshem. Dy teknika mund te konsiderohen alternative potenciale te kirurgjise ne paciente te caktuar qe plotesojne te njetat kriter te pacientet e kirurgjise.

## **Peisimi bikameral**

Mjaft studjues kane investiguar efektet e peisimit bicameral permanent ne pacinete me obstruksion sever te TZ te VM dhe simptoma refraktare ndaj mjekimit ne studime te pakontrolluara. Te dhenat ne keto studime ishin bazuar ne perceptimin subjektiv te nivelit te simptomave nga pacienti ne periudha relativisht te shkurteria kohe. Te dhenat flasin per nje reduktim te rendesishem te gradienteve si dhe permiresim simptomatik ne shumicen e pacineteve qe kane kryer peisim bikameral. Keto observime, cojne ne konkluzion se ulja e gradientit me peisim, lethesojne simptomat. Megjithate, studimet te tjera te kryera ne laboratore kateterizimi tregojne se ulja e gradienteve te TZ te VM e shkaktuar nga nje peisimi sekuencial te perkohshem mund te shoqerohet me efekte te

demshme te mbushjes ventrikulare dhe hedhjes kardiake. Kesisoj, peisimi bikameral ne KMPH ka qene objekt investigimi ne tre studime te randomizuara. Dy prej tyre raportuan se efektet e peisimit mbi KMPH ishin me pak te efektshme sesa ajo qe ish sygjeruar deri atehere. Nje studim tjeter tregoi se gradientet e TZ te VM mbeten te larte edhe pas 9 muajve te trajtimit me peisim. Aftesia ushtrimore, nuk ndryshoi ne menyre sinjifikante ne paciente qe u trajtuan me peisim krahasuar me ata qe nuk e moren kete trajtim. Po keshtu, nuk u pa ndonje lidhje midis reduktimit te gradienteve pas peisimit per nje kohe te gjate krahasuar me ato te peisimit per kohe te shkurter. Si perfundim, deshtimi per te provuar reduktimin e gradienteve nepermjet peisimit, ben qe kjo procedure te mos indikohet ne menyre permanente si procedure kuruese.

Studime te rendesishme si PIC, konkludojne se peisimi eshte dhe mbetet opzion per paciente me simptomatike te shprehur dhe refraktare ndaj mjekimit medikamentoz. Te dhenat e marra nga studimet ne teresi nuk e mbeshtesin perdonimin e peisimit bikameral si trajtim paresor per pacientet simptomatike me KMPH.

Megjithate, ne grupe te vecanta pacientesh, mund te konsiderohet edhe ky peisim si alternative per lethesimin e simptomave dhe reduktimin e gradienteve te TZ te VM. Keshtu, jne vene re permiresim i simptomatikes dhe aftesise ushtrimore pas peisimit ne nje nengrup pacientesh mbi 65 vjec tek te cilet kirurgjia shoqerohet me shkalle me te larte komplikacionesh. Rimodelimi i VM me hollim te mureve si pasoje e peisimit u vu re ne nje studim te pakontrolluar por nuk mundi te konfirmohej ne studime te randomizuara. Po keshtu nuk ka evidence qe peisimi ul shkallen e vdekjeve te papritura, ngadaleson progresionin e semundjes apo jep efekte te favorshme hemodinamike dhe perfitim simptomatike ne paciente me formen jo obstruktive te KMPH. Si efekt potencial pozitiv, peisimi lejon nje trajtim me agresiv duke eliminuar friken e bradicardise se induktuar medikamentoze. Ne disa paciente qe kane defibrilator te implantuar ( per shkak te riskut te larte) dhe kane obstrukcion te TZ te VM shoqerues mund te shfaqin perfitim ne terma te reduktimit te gradienteve nga perdonimi i komponentit peisues te ICD-se. Udherrefyesit e 2002 te AHA/ACC e rendisin perdonimin e peisimit ne pacientet me KMPH me obstruksion me simptoma severe dhe refraktare ndaj mjekimit si indikacion te klases II B. Megjithate, duhet theksuar se mbajtja e terapise se peisimit mund te jete shume me komplekse ne KMPH krahasuar me patologjite e tjera kardiake; prandaj, per te patur rezultate, kjo procedure duhet te kryhet ne qendra te specializuara si per pace-maker ashtu edhe per KMPH. Ndonese peisimi eshte procedura se ciles u jane atribuar me shume studime, akoma nuk ka te dhena per efikasitetin e saj ne pacientet me KMPH ne stade te avancuara.

**Tabela 1. Krahasimi i miptomise septale dhe ablacionit perkutan septal me alkool**

Parametri	Mioektomia Septale	Ablacioni Septal me Alkool
Mortaliteti operator	1%-2%	1% - 2%
Reduktimi i gradienteve(ne qetesë)	Deri 10 mm Hg me pak	Deri ne 25 mm Hg me pak
Simptomat ( subjektive )	Pakesuar	Pakesuar
Simptomat (objektive)	Pakesuar	Pakesuar
Pacemaker	1% - 2%	5% - 10%

Perqindja e pacienteve te perzgjedhur	X	15 -20 X
Risku per VP	Shume e ulet	E paqarte
Ndjekje afatgjate e dokumentuar	> 40 vjet	Rreth 6 vjet
Cikatrice intramiokardiale	mungon	presente

## Ablacioni septal perkutan me alkool ( ASP )

ASP me alkool, eshte opzioni me recent i zhvilluar i kirurgjise ( tabela 1). I prezantuar per here te pare ne 1995, kjo teknike konsiston dergimin me kateter te alkoolit ne nje dege septale te LAD-se per te shkaktuar nje infarkt miokardi ne septumin proksimal ventrikular. Ablacioni septal imiton pasojat hemodinamike te mioektomise duke reduktuar trashesine e septumit bazal dhe ekskursionin, duke zgjeruar trakin zbrates se VM dhe duke ulur shkallen e Levizjen Anteriore Sistolike te valvules mitrale dhe regurgitimit mitral shoqerues.

Kjo teknike, perdon metoda konvencionale dhe teknologji te disponueshme nga semundja e arterieve koronare. Pas kryerjes se koronarografise standarte, nje ballon koronar dergohet ne nje arterie te madhe perforuese septale me ane te nje guide fleksible. Nje kateter peisues i perkozhshem pozicionohet ne apeksin e VD ne rast se zhvillohet bllok atrio-ventrikular i grades se larte. Pas fryrjes se ballonit, nje arteriograma performohet per te verifikuar pozicionimin anatomik te deshiruar te ballonit dhe menjanimin e pikimit te alkoolit ne LAD apo sistemin venoz koronar. Giuda ekografike miokardiale me kontrast eshte e rendesishme ne perzgjedhjen e deges se duhur te arteries perforuese te septumit. Kjo teknike eshte e vlefshme per te percaktuar zonen ekzakte per injektimin e alkoolit dhe per te pare nese ena e zgjedhur furnizon apo jo zona te tjera distante te padeshirueshme per rrezikun potencial te shtrirjes se infarktit ne VD dhe muskujt papilare. Sasia e etanolit qe do te injektohet, vleresohet ne baze te vizualizimit angiografik te anatomise se enes dhe nese kontrasti shpelahet shpejt apo ngadale. Zakonisht, 1.5-2 cc etanol injektohet ngadale ne enen perforuese septale dhe septum nepermjet balonit duke induktuar nje infarkt te diagnostikueshem nga clirim i 400-2500 UI CPK ; ekuivalent me nje zone nekroze 3-10% te mases se VM. ( 20% e septumit ). Sot, qendrat me experience perdonin sasi edhe me te vogla etanolit duke reduktuar zonen e infarktit dhe minimizuar riskun per bllok te plote atrio-ventrikular. Nje procedure e suksesshme con ne nje reduktim te shpejte te gradienteve ne TZ te VM. Zakonisht, ky reduktim ndodh brenda 6-12 muajve, duke u krahasuar me ate te arritur me miotomi dhe duke u shoqeruar me rimodelim te septumit pa prekur ne menyre sinjifikante funksionin global te VM. Kjo eshte raportuar ne paciente me gradiente te medhenj si ne kushte qetesie ashtu edhe tek ata me gradiente ne eforte. Shpesh, vihet re nje perggjigje bifazike e gradienteve pas ASP me alkool. Nje faze me reduktim te madh ( probabilist e lidhur me 'shtangien miokardiale') dhe me pas nga nje rritje deri 50% e gradienteve e krahasuar me gradinetet para procedures diten tjeter. Pas disa muajsh, mund te arrithen nivele te mira reduktimi te gradienteve. Studime te ndryshme kane pare nivel te ngjashem reduktimi gradientesh si me mioektomi ashtu edhe me ASP me alkool. Si pasoje e reduktimit te gradienteve te TZ te VM, normalizimit te presioneve te

VM dhe reduktimit te mbingarkeses sistolike pas procedures se ASP me alkool, eshte pare ( ne studime ekografike ) nje reduktim I shkalles se hipertrofise se VM. Megjithate, shkalla dhe shtrirja e rimodelimit pas procedures eshte nje fenomen jo i kuptuar dhe shpjeguar mire. Po keshtu, ka rezerva per sa i perket shkalles se hollimit te septumit ; proces qe mund te coje ne rritje te shkalles se prekjes nga aritmite dhe ndonjehere duke "afruar" ate qe nijhet si stadi terminal.

Shumica e pacienteve qe u jane nenshtruar ASP me alkool kane demostruar nje nivel te kenaqshem te permiresimit subjektiv per sa i perket simptomave invalidizuese dhe cilesise se jetes ne ndjekjet afatshkurtera 2-5 vjecare. Ashtu sic ndodh edhe me kirurgjine, lethesimi simptomatik akut eshte i ndjeshem. Permiresim objektiv i aftesise ushtrimore eshte dokumentuar edhe me treadmill dhe konsum oksigjeni ne kulm te efortit. Megjithate, ASP me alkool akoma duhet tu nenshtrohet provave te studimeve te gjera te randomizuara apo atyre me ndjekje afatgjate te pacienteve.

Semundshmeria dhe vdekshmeria e lidhur me proceduren e ASP me alkool, ka qene e ulet ne qendra me experience; te ngjashme me ato te miptomise.

Vdekshmeria e lidhur me proceduren shkon nga 1% ne 4% dhe ne studimet e vona raportohet te jete edhe me e ulet. Perdorimi i peisimit permanent si pasoje e bllokut AV te plote si komplikacion i procedures, citohet te jete nga 5% deri 30%, por ky komplikacion eshte me i rralle me perdorimin e dozave te me te uleta te alkoolit. Ne ndryshim nga miotomia septale, e cila shkakton bllok te deges se majte, ASP me alkool zakonisht jep bllok te deges se djathte. Mund te ndodhe qe te shkaktojme disekim te arteries koronare apo edhe ekstravazim te alkoolit retrograd duke dhene okluzion te arteries dhe per pasoje nje infarkt miokardi anteroseptal te konsiderueshem.

Perzgjedhja e mire e pacienteve per AS me alkool mbetet nje moment kyc. Patientet duhet te jene ne kushtet e IK NYHA III ose IV, refraktare ndaj mjekimit medikamentoz qe perdoret ne KMPH dhe me gradiente subaortike  $> 50$  mm Hg te matura me dopler ne ekografi ne kushte qetesie apo edhe ushtrimi.

Ne patientet e perzgjedhur per ASP me alkool, duhet te sigurohemi qe gradientet jane pasoje e Levizjes Anteriore Sistolike dhe kontaktit proksimal valvul mitrale-septum duke perjashtuar patologjite kongenitale te aparatit valvular mitral si inserim anormal i muskujve papilare. Numri i procedurave te ASP me alkool arrin ne 3000 gjate 6 viteve te aplikimit (e dhene e viti 2003) duke barazuar ato te miptomise te kryer ne rreth 40 vjet. ASP me alkool ne ditet e sotme eshte rreth 15 – 20 here me i shpeshte se miotomia. Ka gjasa, qe ky entuziazem te kete ulur pragun e simptomatikes se pacienteve te perfshire ne kete procedure si dhe pragun numeric te gradienteve tek keta paciente duke rritur keshtu ne menyre ndoshta artificiale perqindjen e suksesit. Kjo, ndoshta per avantazhet qe kjo teknike ofron ne term ate rekuperimit me te shpejte dhe lethesise relative te kryerjes krahasuar me miotomine me gjoks te hapur. Shpesh, perzgjedhja e pacienteve eshte bere duke performuar testet farmakologjike ( infusion dobutamine dhe matje gradientesh ) ne vend te testeve ushtrimore me fiziologjike. keshtu, dobutamina eshte nje stimulant I fuqishem I gradienteve subaortike edhe ne zemra normale a po patologji te tjera pervec asaj te KMPH. Perdorimi i saj si test diskriminues nuk inkurajohet ne paciente me KMPH. Nje tjeter shqetesi lidhur me ASP me alkool ka lidhje me riskun afatgjate potencial per shkaktim aritmish dhe ngjarjesh kardiane te lidhura me to –

perfshire edhe Vdekjen e Papritur. Ne dallim nga miotomia, ASP krijon terren te pershtatshem per nje zone te predispozuar per aritmi duke rritur riskun e aritmive rihyrese vdekjeprurese. Kjo eshte e rendesishme sepse shume paciente me KMPH kane edhe vete (pa kryer kete procedure) nje ndjeshmeri dhe potencial te rritur per aritmi. Paraqet rendesi te vecante dhe si pasoje edhe studime me ndjekje te gjate percaktimi i riskut te ngjarjeve kardiake nga ASP me alkool ne paciente te rnj tek te cilet jetegjatesia e pritshme eshte e afert me ate te popullates. Nga te dhenat e deritanishme (i referohemi vitit te botimit) risku i vdekjes se papritur nga aritmite e lidhura me proceduren eshte akoma nje problem i pa kuantifikuar mire. Duke patur parasysh risjet potenciale dhe mungesen e studimeve afatgjata, duhet nje perzgjedhje e mire e pacienteve te pershtatshem per proceduren duke e kufizuar tani per tani kete kategori ne nje nengrup aduktesh. Duhet te konsiderohet trajtimi kirurgjikal tek pacientet me te rnj me me pak semundje bashkeshoqueruese dhe risk te ulet operator. Tek femijet, AS me alkool nuk eshte nje procedure e zgjedhur. Per shkak te heterogenicitetit te shfaqjeve klinike te semundjes, jot e gjithe pacientet me obstruksion jane candidate per AS me alkool. Kjo procedure varet shume nga anatomia e arteries perforatore septale dhe shperndarjen e ngushtimit fiks anatomik. Kjo teknike nuk ndohmon ne rastet kur obstruksioni lidhet me difektet apo varacionet morfologjike te valvules mitrale apo TZ te VM. Ne keto raste, lirimi kirurgjika eshte me llogjik e praktik duke korrigjuar/trajtuar edhe patologji bashkeshoqueruese si SAK, semundjet valvulare primare etj. Po keshtu, lehtesimi i obstruksionit me kirurgji eshte i menjehershem duke perbere nje avantazh jetik ne paciente me simptomatike severe te IK. Te dhenat studimore jane te pakta per sa i perket ASP me alkool; kjo per shkak te numrit te vogel te pacienteve qe plotesojne kriteret. ASP me alkool nuk duhet pare si procedure rutine e realizueshme nga cdo mjek kardiolog intervencionist, por duhet kryer nga qendra tejet te kualifikuara per te patur rezultate te mira dhe komplikacione te pakta proceduriale. Pra, sot ASP me alkool shihet me teper si nje alternative e mundshme ndaj kirurgjisë me teper se nje trajtim primar standart per pacientet me KMPH severe simptomatike refraktare ndaj mjekimit medikamentoz me obstruksion te shprehur te TZ te VM. ( tabela 1 ). Ne kete nengrup pacientesh, miotomia mbetet standarti i arte terapeutik.

**Table 2** Faktoret e riskut per vdekje te papritur ne paciente me kardiomioptati hipertrofike

#### Madhore

- Arrest Kardiak (fibrilacion ventricular)
- Takikardi Ventrikulare e Qendrueshme
- Histori Familjare per VP
- Sinkop I Paspjegueshem
- Trashesi e murit te VM  $\geq 30$  mm
- Rritje anormale e TA ne ushtrim
- Takikardi Ventrikulare e Paqendrueshme

#### Potenciale ne paciente te vecante

- Fibrilacion Atrial
- Iskemi Miokardi
- Obstruksion te TZ te VM
- Mutacione me risk te larte
- Aktivitete sportive kompetitive

#### Vdekja e papritur kardiake ( VP )

## Stratifikimi i riskut

Qe ne momentin e perkufizimit modern te KMPH nga Teare ne 1958, vdekja e papritur ( e pashoqeruar me IK severe) eshte konsideruar si një komplikacion madhor dhe shkaku kryesor i vdekjes ne paciente me kete patologji.

VP mund te jete prezantimi fillestar i semundjes ; me shpesh ne paciente te rind asimptomatike apo me simptoma te lehta. Pacientet me KMPH me risk te larte perbejne një minorance. Per shume kohe, efortet studimore jane fokusuar ne identifikimin e kesaj minorance numerike. VP shpesh ndodh pa prodroma dhe shfaqje qe te lene te dyshosh se dicka fatale eshte duke ndodhur;kryesisht ne oret e para te mengjesit, dhe me e shpeshte neadoloshente dhe adultet e rind. Nuk dihet shkaku i kesaj “preference” te ketij komplikacioni fatal. Kjo nuk do te thote qe personat me KMPH qe kalojne kete prag moshe jane te sigurt. VP ndodh me shpesh ne eforte minimale apo jete sedentare apo edhe ne gjume. Perqindja me e madhe e VP eshte e lidhur me KMPH. Kjo nuk kurson as atletet e angazhuan ne sporte kompetitive.

Te dhenat qe disponohen sugjerojne se takiaritmite komplekse ventrikulare lindin nga substrati jo stabel elektrik dhe jane shkaku me bindes i lidhur me VP ne pacientet me KMPH. Ne monitorimin 24 oresh te ritmit, gati 90% e pacienteve me KMPH kane aritmi komplekse ventrikulare; shpesh komplekse. Ne paciente te tjere, jane takikardite supraventrikulare qe mund te nxisin apo shperthejne takikardite ventrikulare jetekercenuese. Ne raste te tjera, bradiaritmite behen potencialisht jetekercenuese dhe kerkojne peisim permanent.

Eshe sugjeruar se takiaritmite jete kercenuese mund te provokohen edhe nga faktore te ambientit (si sforcimi fizik i madh) si dhe nga vete pasojat e semundjes nepermjet krijimit te një cirkuli vicioz qe con ne rritjen e shkalles se iskemise miokardiale dhe disfunkzioni diastolik te ndikuar nga obstruksioni i TZ te VM, hipertensioni arterial apo vete aritmite supraventrikulare qe ulin perfuzionin koronar dhe volumin hedhes.

Pavaresisht arritjeve ne perpjekjet per stratifikimin e pacienteve sipas riskut per VP, akoma nuk ka markera klinike apo laboratorike qe mund te perdoren ne menyre te pa revokueshme. Akoma ky problem mbetet per tu zgjidhur dhe sfide per shkak te spektrit te gjere te prezantimit klinik te KMPH dhe prevalences relativisht te ulet ne praktiken mjekesore.

Gjithsesi, eshte e mundur identifikimi i pacienteve me risk me te larte me metoda jo invazeive dhe vetem një minoritet i pacienteve me KMPH qe vdesin ne menyre te papritur (rreth 30% e tyre) nuk kane patur alterim te markerave qe sherbejn per stratifikim te riskut.

Faktoret e meposhtem, jane te lidhur me një risk me te larte per VP:

- 1) arrest kardiak i meparshem apo takikardi ventrikulare
- 2) histori familjare per VP te lidhur me KMPH
- 3) identifikimi i genit mutant
- 4) sinkop i pashpjegueshem sidomos ne paciente te rind apo i lidhur me efortin dhe i perseritur.
- 5) pergjigje anormale e TA ne efort apo hipotension ushtrimor.

Hipertrofi ekstreme e VM me trashesi te murit 30 mm ose me shume sidomos kur kjo verehet neadoloshente. Pacientet nen 60 vjec me KMPH duhet tu nenshtrohen vleresimit ekstensiv kardiak cdo vit per te stratifikuar riskun dhe evolucionin e simptomave duke marre me kujdes edhe anamnezen familjare, ekokardiogramen dy-dimensionale, holter ritmi 24 oresh per te pare pranine e TV dhe per gjigjen e TA gjate ushtrimit. Sot, vemendje e madhe po u kushtohet magnitudes se hipertrofise se VM sin je tregues I riskut. Dy grupe te pavarura kane reportuar nje lidhje direkte midis shkalles se hipertofise se VM dhe VP. Keshtu, nje populete prej 10% e pacienteve me KMPH qe kane trashesi septale mbi 30 mm kane nje risk te rendesishem afatgjate per VP. VP eshte me e shpeshte ne paciente asimptomatike apo lehtesisht simptomatike adoloshente dhe eshte vleresuar te jete 20% per nje periudhe 10 vjecare. Te dhenat e studimeve retrospektive kane gjetur se hipertrofia ekstreme eshte nje faktor riziku per VP. Eshte pare nje relacion midis moshes se re dhe VP; me e shprehur kjo kur trashesia septale shkon mbi 35 mm. Kjo trashesi eshte me e shpeshte ne moshat e reja dhe perben vetem 1% te pacienteve mbi 50 vjec. Nje tjeter grup studimor ka konkluduar se hipertrofia ekstreme mbart nje risk te rritur per VP kur eshte e lidhur edhe me faktore te tjere riziku si sinkopi i pa shpjegueshem, histori familjare per VP, takikardi ventrikulare te paqendrueshme ne holter apo per gjigje anormale e TA ne efort. Sot (deri ne momentin e botimit) nuk ka evidence te plete qe te provoje se hipertrofia ekstreme eshte nje faktor riziku indipendent per VP duke justifikuar keshtu parandalimin nepermjet implantimit te ICD-se. Kjo procedure duhet marre ne konsiderate kur vjen fjala per paciente te rind ne moshe.

Te gjitha keto, nuk duhet te lene te mendohet e kunderta; d.m.th qe paciente me shkalle hipertrofie nen 30 mm kane risk te ulet , pasi ne keto raste duhet te konsiderohen edhe faktoret e tjere te riskut. Keshtu, shumica e pacienteve qe bejne VP, kane shkalle hipertrofie me te ulet se 30 mm.

Ndonese prognoza nuk eshte e lidhur ngushte me paternin e shperndarjes se hipertofise se VM, shkalla e evidences sugjeron se trashja murore segmentare ne nivele nen 20 mm zakonisht shoqerohet me prognoze te favorshme ne mungese te faktoreve te tjere te riskut. Hipertofi e tillë segmentare perfshin edhe formen jo obstruktive te KMPH te kufizuar ne pjesen me distale te VM ( “KMPH apikale”).

Rregullimi i disorganizuar i muskulit kardiak, cikatrica e miokardit,dhe zgjerimi i matriksit te kolagjenit krijojnë substratin pro aritmogenik duke i ekspozuar pacientet ndaj aritmive me mekanizem rihyres. Ndonese kuptohet qe hipertrofia ekstreme pritet te jape komplikacionet e mesiperme, ne nivel studimesh nuk ka evidence qe te lidhe direkt shkallen e hipertofise me shkallen e disfunktionalit diastolik dhe simtomat invalidizuese. Ne menyre paradoksale, shumica e pacienteve me hipertrofi ekstreme nuk paraqesin te njejten shkalle severiteti simptomash,obstrukzioni te TZ te VM apo zgjerimi te atriumit te majte. Eshte nje konsensus klinik qe simptoma me predominante e lidhur me riskun e larte per VP eshte presinkopi dhe sinkopi. Gjithsesi, sensitiviteti dhe specificiteti i sinkopit si parakallezues i VP jane te ulet. Kjo sepse sinkopi ne mjaft raste nuk i detyrohet aritmise apo obstrukzionit te TZ te VM. Ne te vertete ka shume shkaqe te sinkopit disa prej te cilave nuk lidhen direkt me gjendjen e semundjes dhe jane neurokardiogjenike. Edhe kur shkaku i humbjes se ndergjegjjes nuk gjendet, duhet te

konsiderojme edhe KMPH sidomos kur sinkopi ndodh ne paciente te rinj, kur lidhet me efortin dhe kur jane te perseritur. Prandaj sinkopi justifikon implantimin e nje ICD-je per te parandaluar pasojat e aritmive jetekercenuese. Obstrukzioni i TZ te VM kur gradienti eshte  $> 30$  mm Hg mund te shihet si nje faktor i vogel rishku per VP. Impakti i gradientit ne riskun per VP nuk eshte i mjaftueshem per te perbere nje faktor te pavarur dhe per te percaktuar nje *cuttof* ne vendimin per te implantuar nje ICD ose jo per efekt profilaktik. Identifikimi i KMPH ne femije eshte tejet e pazakonshme dhe shpesh krijon nje dileme klinike sepse nje diagnoze e tille ngre paqartesi mbi riskun afatgjate. Eshte propozuar ( mbi bazen e studimeve gjenotipike-fenotipike ) se difektet gjenetike per gjegjese per KMPH prezantojne determinantin paresor dhe markerin stratifikues per prognozen e semundjes, VP dhe riskun per IK. Keshtu, mutacionet e ne zinxhires rende kardiake beta-miozine dhe ato te troponines T lidhen me nje incidence me te larte per VP, ulje te jetegjatesise se pritshme dhe shfaqje te hershme te simptomave. Megjithate, studimet jane akoma ne proces dhe nxjerra e konkluzioneve definitive bazuar ne mutacionet gjenetike eshte e parakohshme. Si pasoje, prania apo mungesa e nje mutacioni nuk ka akoma implikime terapeutike dhe efekt prognostik te pavarur. Nuk ka evidence bindese se markerat invazive kane nje rol te rendesishem rutine ne identifikimin e pacienteve me KMPH qe kane nje substrat instabel elektrikisht dhe jane ne risk te larte per VP nga aritmite madhore ventrikulare. Sic ndodh edhe ne semundjen e arterieve koronare dhe kardiomiopatine e dilatuar, takikardite ventrikulare polimorfe dhe fibrilacioni ventrikular konsiderohen si per gjigje jo specifike ndaj stimujve shtese ventrikulare. Tashme koncepti mbizoterues eshte se studimet elektrofiziologjike per nxitjen e aritmive dhe proven e stimulimit jane nje rutine jo e dobishme qe nuk sherbejne ; me perjashtim kjo te nje grupi te vogel patientesh me sinkop te paspjegueshem.

Shumica e markerave ne KMPH kane perdonim te kufizuar per shkak te vlerave te uleta pozitive predictive parakallzuese te ndikuara edhe nga incidence e ulet e ngjarjeve. Megjithate, vlerat e larta negative parakallezuese te ketyre markerave ( rreth 90%) te tyre sugjerojn se mungesa e faktoreve te riskut dhe disa karakteristika klinike mund te sherbejne per te ndertuar nje profil me gjasa te pakta per te patur VP apo ngjarje te tjera. Keshtu, patientet adulte mund te konsiderohen me risk te ulet nese ata demostrojne 1) dhimbje te lehta gjoksi te lehta ose dispne eforti (NYHA I ose II); 2) mungese te histories familjare per VP nga KMPH 3) mungese sinkopi qe mendohet te jete e lidhur me KMPH 4) TV te paqendrueshme te kapur ne monitorimin 24 oresh te ritmit;

- 5) gradient qetesie ne TZ te VM me te vogel se 30 mm Hg);
- 6) Atrium te majte me te vogel se 45 mm ; 7) per gjigje normale e TA ne ushtrim; dhe 8) hipertrofi te lehte te VM ( trashesi muri nen 20 mm ).

Patientet me progoze te mire ne mungese te faktoreve te riskut perbejne nje perqindje te rendesishem te popullsise te pacienteve me KMPH. Shumica e tyre nuk kerkojne trajtim agresiv medikamentoz dhe meritojne nje siguri per sa i perket progozes se tyre. Nuk keshillohet kufizim ne aktivite te perditshme te tyre ndonese u rekomandohet mospjesemarrje ne sportet kompetitive.

## Parandalimi

Perpjekjet per parandalimin e VP kane patur si shenjester nje minoritet pacientesh me KMPH tek te cilet riku per VP ishte teper i larte per tu marre ne konsiderate.

Historikisht, strategjite terapeutike qe synojne te reduktojne riskun per VP apo te vonojne progresionin e simptomave te lidhura me kongestionin jane mjaftuar ne perdonimin e medikamenteve si beta blokuesve, verapamilit dhe antiaritmikeve te klases I ( Kinidine, Procainamide) tek pacientet e konsideruar me risk te larte. Nuk ka prova qe kjo taktike e administrimit empirik te medikamenteve ne paciente asimptomatike te kete ndikuar ne reduktimin e riskut. Sot, kjo strategji konsiderohet e dale mode duke u zevendesuar me procedura me recente sic eshte ICD. Per me teper, doza te uleta te amiodaronit (rreth 300 mg) jane pare te permiresojne mbijetesen duke patur parasysh nevojen e madhe qe ka ky medikament per monitorim dhe pamundesine per tu toleruar nga te gjithe pacientet per shkak te toksicitetit dhe riskut afatgjate te perdonimit; sidomos ne paciente te rinj.

ICD eshte mjeti prevenues me efektiv kur nje pacient ka risk te larte per VP. (fig 1) Ne nje studim multicentrik, ICD-ja senson dhe shuan aritmite me potencial vdekjeprures duke rivendosur ritmin sinusal ne rreth 25% te pacienteve me risk te larte ne nje periudhe kjo ndekjeje 3 vjecare.

Perqindja e vendosjes se ICD eshte 11% ne vit per parandalim dyesor (arrest kardiak i rikuperuar dhe aritmi e qendrueshme ventrikulare) dhe 5% ne vit per parandalim paresor ne paciente me simptoma te lehta dhe ata asimptomatike. Eshte akoma e veshtire te konsiderohet raporti kosto-perfitim per perdonimin e ICD-ve ne parandalim paresor, pasi shpesh nuk jemi ne gjendje te parashikojme se kur do ti duhet ICD-se te defibriloje dhe sa here gjate jetes se pacientit me KMPH.

ICD eshte i rekomanduar per parandalim dyesor ne paciente me arrest kardiak te meparshem apo TV te qendrueshme.

Prania e faktoreve te shumte te riskut mbart edhe potencialin e larte per VP cka justifikon perdonimin e ICD si mjet profilaktik paresor. Gjithsesi, gjykimi nese nje pacient eshte nje kandidat i mire per ICD mbetet subjekt i vleresimit individual te mjekut dhe profilit te riskut te vete pacientit.

Po keshtu, tendenza per te shkuar drejt ICD ndryshon ne zona te ndryshme te botes – bazuar kjo ne shume faktore. Udherrfyesit e ACC/AHA/NASPE te 2002 e kane konsideruar ICD per parandalim paresor si indikacion te klases **IIb** kurse per parandalimin dyesor si klase **I**.

Sot ka nje stepje te kuptueshme te kardio pediatreve per te implantuar ICD ne femije (sidomos per parandalim paresor) duke menduar per mirembajtjen, dhe potencialin per komplikacione ne terma afatgjate. Ndonese adoloshenca eshte periudha me e veshtire per tu “pajtuar” me mbajtjen e nje ICD-je, duhet thene se kjo periudha perkon njekohesht me momentin me risk me te larte per VP ne te semuret me KMPH. Nje alternative empirike e propozuar per pacientet teper te rinj me risk te larte, eshte administrimi i amiodaronit si nje ure deri ne momentin e vendosjes se ICD dhe pritis qe

femija te jete i ndergjegjshem e te maturohet edhe psikologjikisht. Disa studjues, e konsiderojne fazen e end-stage te KMPH si një faktor rishku per VP, duke e justifikuar vendosjen e ICD gjate periudhes priteze per transplant kardiak.

## Rekomandime per atletet

Ne perputhje me rekomandimet e panelit te eksperteve mbi pacientet e rinj ne moshe me KMPH, keta te fundit duhet te perjashtohen nga sportet kompetitive qe kerkojne angazhim fizik. Kjo per shkak te riskut te larte per VP qe mund te shoqeroje keto aktivitete. Eshte pare një lidhje midis VP dhe aktivitetit kompetitiv ne atlete me semundje shoqueruese kardiovaskulare (perfshire ketu edhe KMPH). Ka evidence indirekte qe terheqja e ketyre atleteve nga sporti redukton rishkun per VP.

Jo te gjithe atletet me KMPH pesojne VP gjate fazes se ushtrimit te sportit - vetem ne një perqindje te tyre ndodh një gje e tille. Stratifikimi i riskut eshte i veshtere, pasi ketu nderhyjne edhe kushtet e ambientit ndaj te cilave jane te ekspozuar. Terheqja e kesaj kategorie njerezish nga kjo menyre jetese, sot shikohet si një zgjedhje terapeutike. Ne persona te tjere qe nuk jane te angazhuar ne aktivitete kompetitive, nuk rekomandohet ndryshimi i stilit te jetes dhe kufizimet ne aktivitetin e perditshem - ndonese aktiviteti fizik me intensitet apo ushtrimi izometrik duhet evituar. Ndonese nuk ka te dhena te sakta, mendohet se personat me mutacion gjenetik por pa shfaqje fenotipike, nuk kane nevoje tu nenshtrohen ketyre masave kufizuese per sa i perkthet aktivitetit te perditshem. Nga ana tjeter, ne keta persona, ka vend kontrolli periodik per te vleresuar shkallen e riskut.

## Fibrilacioni Atrial ( FA )

FA eshte aritmia me e shpeshte e instaluar ne pacientet me KMPH dhe zakonisht kerkon strategji agresive terapeutike. ( fig 1 ). Episodet paroksistike apo kronike te FA ndodhin ne 20 – 25% te pacienteve me KMPH te lidhura me zmadhimin e AM dhe moshimin e te semureve. Per me teper, ka mundesi qe kriza te pazbuluara FA te jene edhe me te shpeshta sesa raportohet. FA tolerohet relativisht mire ne 1/3 e pacienteve dhe nuk eshte faktor parakallezues i pavarur per VP; gjithsesi, eshte e mundur qe ne paciente te prekshem FA mund te shpertheje aritmi ventrikulare jetekercnuese. FA eshte i lidhur ne menyre te pavarur nga faktoret e tjere me vdekjen nga insuficiencia kardiake, insultin fatal dhe ate jo fatal si dhe progresionin afatgjate te semundjes drejt insuficiencies kardiake. Episode kalimtare te FA ndodhin ne rreth 30% te pacienteve qe i nenshtrohen mioektomise septale, zakonisht ne paciente me episode te meparshme FA. Risku per komplikacione te FA rritet kur aritmia behet kronike, fillon par ate pesedhjetave dhe kur ka obstrukcion te TZ te VM. Episode paroksistike mund te jene perjegjese per perkeqesim akut klinik me gjendje sinkopale dhe shenja te IK nga reduktimi i mbushjes diastolike dhe hedhjes kardiake-pasoje e shtimin te frekuences kardiake dhe humbjes se

kontributit atrial ne terren te shkurtimit te diastoles ne nje VM te hipertrofuar me demtim paraekzistues te funksionit relaksues dhe ulje te kompliances. FA ne terren te KMPH manaxhohet sipas udherrefyesve te ACC/AHA. Tentative per konvertim medikamentoz apo elektrik eshte procedura e preferuar ne paciente me FA nen 48 ore duke menduar qe nuk kemi tromb te formuar ne aurikulan e majte. Amiodaroni konsiderohet si antiaritmiku me efektiv per parandalimin e krizave te FA pas konvertimit. Tek pacientet me KMPH, kerkohet qe mbajtja e ritmit sinusal te jete ne plan te pare sepse ne keta te semure, FA eshte prekusor i IK dhe insultit.

Ne FA kronik, beta bllokuesit, verapamili dhe digoksina jane pare te jene efektive ne kontrollomin e frekuences kardiake; ndonese ablacioni i nyjes A-V dhe peisimi permanent mund te jene te nevojshem ne paciente te vecante. Terapia me antikoagulante indikohet si ne FA paroksizmal edhe ne ate kronik. Pragu I fillimit te terapise antikoagulante duhet te jete I ulet, pasi eshte pare se risku per trombemboli sistemike eshte i larte edhe me nje apo dy episode te vecuara te fibrilacionit atrial paroksizmal. Warfarina eshte medikamenti i zgjedhur. Dihet qe perdonimi i saj, nuk mund te neutralizoje plotesisht riskun per insult. Akoma nuk dihet me saktesi terapia e zgjedhur per paciente me aritmi jo te qendrueshme ventrikulare asimptomatike. Ka akoma pak eksperience ne kete kategori pacientesh lidhur me efikasitetin e procedurave te MAZE apo ablacionin me radio-frekuence – teknika te perdonuara ne paciente me FA pa KMPH.